

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Shkodër, 2023

TITULLI ORIGINAL
NAMAZ

PËRKTHEU
Ilir Hoxha

REDAKTOI
Albert Halili

FAQOSI
Bledar Xama

BOTIMI I
Shkodër, 2023

PROGRESI BOTIME
Sheshi “2 Prilli”, Rr: Studenti
Shkodër, Shqipëri
Mob: +355 67 340 6182

NAMAZI

Osman Nuri Topbaş



Përmbajtja

Prezantim	7
Namazi	11
Abdesti, Tejemmumi, Gusli, Namazi	121



Prezantimi

Falënderimi i takon Allahut të Madhëri-shëm, i Cili na fali neve, robërve të Tij të dobët, mirësinë dhe paqen e besimit!

Lutjet dhe përshëndetjet më të bukura qofshin mbi Profetin tonë të nderuar ﷺ, i cili u bë shkak i udhëzimit të njerëzimit në besim dhe të daljes nga errësira në dritë!

Çdo person i arsyeshëm mund ta kuptojë lehtësisht se; bota nuk u krijua pa një qëllim dhe jeta nuk u la në një rrjedhë absurde dhe të rastësishme. Për këtë arsye, mesazhet hyjnore i janë dërguar njerëzimit gjithmonë nga Allahu nëpërmjet profetëve dhe ata janë urdhëruar: **“O njerëz! Ky është sirat-i mustakim/rruga e drejtë në të cilën duhet të ecni!”**

Shkurtimisht, këto kumtime hyjnore të



quajtura “fe e vërtetë” ose “Islam”, janë padyshim një mirësi që i zgjon të gjithë njerëzit nga indiferenca, në rrugën drejt udhëzimit, mëshirës dhe mirësisë së përjetshme, dhe i çon ata drejtë lumturisë së ahiretit.

Në këtë aspekt, mirësia e Islamit, është e para ndër dhuratat më të mëdha të Allahut të Madhëruar për njerëzimin. Besimtarët, të cilët kanë gëzuar këtë bekim hyjnor, nga Ademi عليه السلام, e deri më sot, e kanë ruajtur natyrshmërinë e krijimit të tyre në saje të Islamit dhe i kanë kthyer zemrat dhe tërë botën në një bahçe trëndafilash.

Të drejtët dhe besimtarët, të cilët kanë fituar një nivel më të lartë, kanë arritur në shkallë dhe pozita më të larta se melekët. Kështu, ata arritën gëzimet më të bukura të lumturisë që plotëson nevojat e tyre natyrore.

Prandaj, është thelbësore që myslimani ta jetojë Islamin, në horizontin shpirtëror, në përputhje me moton *“të njohësh të vërtetën ashtu si është dhe ta ndjekësh dhe të njohësh të pavërtetën ashtu si është dhe të shmangësh prej saj”*.



Për shkak se feja e fundit dhe më e përsosur e Fundit të Kohës është Islami, edhe devotshmëria/takvaja, konsiston në përjetimin e besimit me entuziazëm, duke përmbushur kushtet e Islamit me frikë-respekt dhe duke marrë shembull nga jeta e Profetit ﷺ dhe shokëve të tij.

Kjo, sepse besimi është një jetë e përbërë nga drita e fesë që hyn në zemër, që do të thotë, të jetosh me dritën e Allahut. Ndërsa takvaja, është pastrim i zemrës, e cila është vendbanimi i besimit. Morali i bukur, adhurimi dhe veprat e mira janë gjithmonë shfaqje e takvasë.

Prandaj, duhet ta dimë mirë se; të jesh mysliman e të jetosh si jomuslimanët, nuk i jep lumturi qenieve njerëzore. Dobia e vërtetë tek Allahu, është ta jetosh jetën islame me zemër të pastër, duke përjetuar mallin e takimit me Allahun dhe entuziazmin e Islamit si në Epokën e Lumturisë.



NAMAZI

Elementi i parë i adhurimeve islame, shtylla e fesë, drita e besimit, miraxhi i besimtarëve

Jeta e njeriut është e mbushur me shfaqjet e kërkimeve të një të vërtete për të arritur te Krijuesi i Gjithësisë. Këto shfaqje janë rezultati i natyrshëm i prirjes për të besuar dhe adhuruar, një cilësi, kjo, e pranishme dhe e pandryshueshme në krijimin e njeriut, ashtu që është një e vërtetë krejt e hapur, e vëzhguar paprerë qysh në krye të herës e gjer më sot, se njerëzit e panjohur me Zotin dhe të vërtetën, duke kërkuar për ta kënaqur dhe heshtur këtë prirje, janë zvarritur në sa e sa aventura jologjike, të çuditshme e absurde gjer te adhurimi i një krijese të dobët! Me të vërtetë, edhe sot, madje, dihet se miliona njerëz u atribuojnë shenjtëri krijesave të tilla si



lopa ose, siç ndodh te fetë e korrigjuara, zvarriten pas një besimi antropomorfist siç është përpjekja për ta përfytyruar dhe trajtësuar Krijuesin Transcendental (Rabbi Muteal).

Dhe kjo tregon se njeriu, si konkretizim i pohimit Kuranor si më poshtë, është paprerë nevojtar për të adhuruar dhe për ta jetuar pozitën e tij te adhuruesit:

وَمَا خَلَقْتُ الْجِنَّ وَالْإِنْسَ إِلَّا لِيَعْبُدُونِ

“Unë krijova njerëzit dhe xhindët vetëm për të më adhuruar Mua.” (Dharijat, 56)

Për rrjedhojë, njeriu arrin shpëtim dhe lumturi me aq sa ta orientojë këtë prirje të natyrshme në mënyrë të merituar për nderin dhe dinjitetin njerëzor. Sepse, në këtë botë stolisur me një mijë e një qëndisje të fuqisë hyjnore, njeriu është krijuar që të përbëjë kulmin e artit hyjnor dhe, si një rezultat ndërgjegjësor i këtij krijimi, është ngarkuar me përgjegjësinë për ta adhuruar dhe madhëruar Zotin e vet. Dhe kjo gjer në atë nivel saqë të gjitha veçoritë dhe dhuntitë e larta të dhëna njeriut janë lidhur me zbatimin e kësaj përgjegjësie, për çka dhe në Kuran thuhet:



قُلْ مَا يَعْبَأُ بِكُمْ رَبِّي لَوْلَا دُعَاؤُكُمْ

“Thuaj: “Po qe se nuk luteni dhe nuk adhuron, përse Zoti t’ju japë vlerë?!..”

(Furkan, 77)

Ja, pra, lidhur me këtë, në shumë ajete Kuranore Zoti deklaroi se, që njeriu të shpëtojë nga disfata e amshuar, duhet ta shoqërojë besimin me adhurim dhe punë të mira. Kështu, besimtarët që kanë vënë si synim të dalin në audiencën e lartë të Zotit me zemër të pastër, ua dorëzojnë zemrat burimeve sublime të adhurimeve, të quajtura punë të mira (amelisalih) dhe marrin rrugë drejt detit të afishtë hyjnore.

Dhe më i madhi e më i rëndësishmi i burimeve adhurimore që e çojnë, në këtë mënyrë, adhuruesin drejt detit të afishtë hyjnore, është, pa asnjë dyshim, adhurimi i namazit. Sepse, për nga përfshirja, përmbajtja dhe niveli, namazi është thelbi dhe kulmi i adhurimeve.

Të gjitha sendet në gjithësi, si dielli, li-vadhi, bari, pemët, etj. ndodhen në gjendje dhikri. Zogjtë që fluturojnë të vënë në radhë, malet, gurët, etj., e adhurojnë Zotin, i falen



Atij me një gjuhë madhëruese, cilësia e së cilës është e panjohur për ne. Bimët e bëjnë faljen dhe adhurimin në pozicionin në këmbë (kijam), kafshët, përkulur (ruku), kurse gjërat e quajtura jo të gjalla, për tokë (sexhde).

E tillë është edhe gjendja e banorëve të qiellit. Një pjesë e engjëjve ndodhen në gjendje qëndrimi drejt (kijam), një pjesë, në qëndrimin përkulur (ruku), një pjesë në gjendje sexhdeje, kurse një pjesë tjetër, në gjendje përmendjeje të Zotit me fjalë madhëruese (tesbih) dhe duke thënë “La ilahe il’lallah”, “Nuk ka zot tjetër veç Allahut” (tehlil).

Ndërkaq, adhurimi i namazit, dhuruar besimtarëve nga Allahu si një miraxh, i përmban të gjitha këto forma adhurimi. Për rrjedhojë, adhuruesit e vërtetë, domethënë falësit e namazit, të cilët bëjnë një adhurim që përmban tërë format e adhurimeve të bëra nga të gjitha qeniet në tokë e në qiej, arrijnë shpërblime të pallogaritura si dhe bëhen dëshmitarë të shfaqjeve të brendshme.

Sa bukur e shpreh Sulejman Çelebiu këtë veçori të namazit:



*Kushdo që këtë namaz e fal,
Merr të mirat e të gjithë ç'ndodhen në qiell...
Sepse çdo lloj adhurimi ndodhet në të,
Krijimi i afërsisë me Zotin ndodhet në të
Në hadithin profetik thuhet:*

*“Namazi i përfton njeriut e Allahut të
Lartë. E bën ta duan engjëjt. Është rruga
e profetëve. Është drita e njohjes intuitive
(marifet) të Zotit. Është thelbi i besimit.
Është pretekst i pranimi dhe plotësimit
të lutjes. I bën punët të bekuara e të pra-
nueshme. E shton furnizimin (rizk). I jep
prehje trupit. Është armë kundër armiq-
ve. E largon shejtanin. Ndërmjetëson mes
falësit të namazit dhe engjëllit të vdekjes.
Është kandil dhe shtresë në varr. Është për-
gjigje për engjëjt Munker dhe Nekir. Është,
për të vdekurin, shok rruge gjer në kiamet.
Në ditën e kiametit është hije mbi ata që
kanë falur namaz. Është kurorë mbi kokë.
Është rrobë për trupin. Është dritë që prin.
Është një perde mes falësit të namazit dhe
njerëzve të tjerë. Është këshilltari i besimta-
rëve në audiencën e Zotit. Është peshë në
peshoren e ditës së llogarisë (mizan). Është*



kalim nëpër Sirat. Është çelës për në xhen-net. Sepse namazi është madhërim (tesbih), laudërim dhe falënderim (hamd), këndim Kurani (kiraat) dhe lutje. Shkurt, tërësia e të gjitha akteve të çmuara e të virtytshme është në namazin e falur në kohë.” (Tenbihul Gafilin, 293)

Prandaj namazi është pikëtakimi me Allahun dhe i është dhuruar ummetit, bashkësisë, si një miraxh i vogël. Dhuntia e mundësisë për të dalë para Zotit fitohet me anë të namazit, ashtu siç urdhërohet edhe në Kuran:

“Bjer në sexhde dhe afrohu!” (Alak, 19)

Në namazin e vërtetë, i gjithë vaniteti mënjanohej, çdo gjë që i përket kësaj bote, fshihet. Në kuvendin e takimit, robi me Zotin janë bashkë. Njeriu kapërcen distanca drejt thellësive të enigmave hyjnore. Sepse, pas takimit në miraxh, namazi i është bërë Muhamedit ﷺ detyrim (farz) pa praninë e Xhebrailit, kështu, ai është caktuar për të mbetur vetë për vetë me Allahun, pa vënë as ndonjë gjë ndërmjet. I Dërguari i Allahut ﷺ, i cili, në këtë afri vetë për vetë, jetoi vazhdimisht atë gjendjen e miraxhit “sa dy harqe larg” (kaabe kavsejn) ka thënë:



“Namazi është drita e syve të mi!” (Nesai, Ahmed bin Hanbel).

Përkryerja, qetësia, prehja, kënaqësia dhe afërsia të fituara me namaz nuk mund të fitohen me asnjë adhurim tjetër.

Grada, pozita e namazit në këtë botë është si grada apo pozita e shikimit dhe sositjes së Zotit në jetën e pasme (ahiret). Sepse çastet kur njerëzit ndodhen më pranë Zotit në këtë botë, janë çastet e namazit. Kënaqësitë më të imta dhe shfaqjet moralo-shpirtërore janë në namaz. Mund të thuhet se të gjitha adhurimet janë, pothuaj, si shkallare për ta përgatitur njeriun për namaz. Prandaj, sipas shprehjes së Profetit ﷺ, namazi “është shtylla e fesë, drita e besimit dhe zemrës, çelësi i lumturisë, miraxhi i besimtarit”.

Me të gjithë cilësinë e vet, namazi është një adhurim i veçantë e i posaçëm, i përpjesëtuar mes Zotit dhe robit. Domethënë, namazi është si sureja “Fatiha”. Në “Fatiha”, pjesa nga Besmeleja gjer te ajeti “maliki jeumiddin”, “i zoti i Ditës së Fesë”, është e posaçme për Zotin. Ajeti “Ijjake na’budu ve ijjake neste’in”, “vetëm Ty të falemi dhe vetëm Ty të thërre-



sim për ndihmë”, me njërin aspekt të saj, i përket Zotit, me aspektin tjetër, njeriut, duke sintetizuar konceptet e robit si adhurues i Zotit dhe të Zotit si i adhuruari i robit. Me fjalë të tjera, në kuadrin e të vërtetës se Allahu është i vetmi i adhuruar, robi ia kushton adhurimin vetëm e vetëm Allahut. Kurse ajetet në vijim i përkasin robit. Kështu, në hadithin e shenjtë thuhet:

“Namazin e ndava më dysh mes meje dhe robit tim, gjysma është e imja, gjysma, e tij.” (Muslim, Salat, 38-40)

Për rrjedhojë, namazi është, mes Allahut dhe njeriut, një lutje, një përgjërëm, një thirrje. Namazi është një zikr, përmendje. Zoti urdhëron:

“Fal namaz për të më përmendur mua!”
(Taha, 14)

Gjithashtu, e fshehta e ajetit të mëposhtëm, realizohet, më shumë se në çdo adhurim tjetër, në namaz:

“Përmendmëni mua që edhe unë t’ju përmend ju!..” (Bekare, 152)



het hadithi i shenjtë, “...Unë jam bashkë me atë që më përmend mua...” (Buhari, Tevhid, 15)

Ndërkaq, që njeriu të mund të përfitojë siç duhet nga kjo të qenët bashkë, është e domosdoshme të ndodhet në gjendjen e quajtur “përkushtim i plotë” (ihsan). Profeti ﷺ porositi:

Ihsan është adhurimi sikur të jesh duke e pare Allahun! Po s’e pe ti Atë, as Ai s’të sheh ty!..” (Muslim, Iman, 1)

Ja, namazi i falur kështu bëhet “dritë e syve”!

Për ata që munden ta falin namazin kështu, prodhohet një shfaqje nga grada e Profetit. Dhe kjo është, për njeriun, një gradim, një dhënie përfaqësimi nga ana e Allahut.

Prandaj, namazi është si druri dritëlëshues që i tregonte rrugën Musait. Namazi është ngushëllimi i zemrave të thyera, qetësimi i zemrës së lodhur nga grindja e kësaj bote, ushqimi sublim i shpirtit, shërimi i zemrave dhe gjuha e njerëzve të pajisur me diturinë moralo-shpirtërore (arif). Kur Profetit i shkaktonte rëndesë në zemër preokupacionet materiale, i thoshte Bilalit:



“O Bilal, na këndo një ezan e na qetëso!”

Sepse nuk ka asnjë adhurim që t'i përngjasë namazit.

Personi që fal namaz, nuk merret me asgjë tjetër veçse me namazin e vet. Namazi ia pret atij të gjitha lidhjet. E bën të jetojë një afër të papërshtueshme kokë më kokë me Zotin. Kurse me adhurimet e tjera nuk ndodh kështu. Për shembull, njeriu i agjëruar mund të jetë në treg edhe shitës, edhe blerës. Po kështu edhe ai që bën haxh. Kurse ai që falet, gjatë faljes nuk mund të bëjë asnjë veprim tjetër jashtë namazit. Në përmbajtje e cilësi, ai ndodhet në audiencën hyjnore.

Ashtu siç thotë ajeti Kuranor,

إِنَّ الصَّلَاةَ كَانَتْ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ كِتَابًا مَّوْقُوتًا

“Pa dyshim, për besimtarët është i detyruar namazi i caktuar në kohë.” (Nisa, 103), besimtarët e vërtetë, duke u pjekur çdo ditë e më shumë edhe me namazet suplementare (nafile) krahas namazeve pesë herë në ditë gjatë gjithë jetës, më në fund, si përgjigje ndaj



urdhrit hyjnor, “irxhiaí ila Rabbike”, “kthehu te Zoti yt”, bashkohen me robtë e virtytshëm dhe fitojnë “portën e paqes” (darus selam)!

Këta besimtarë ndodhen në pozitën e karakterizuar në ajetin:

“Përmendmëni mua që edhe unë t’ju përmend ju.” (Bakara, 152)

Ata kanë marrë pjesë nga deklarata hyjnore:

“Përmendja e Allahut është më e madhja!” (Ankebut, 45)

Kjo shprehje, siç do të thotë që “përmendja e Allahut, namazi, është puna më e madhe”, do të thotë, në të njëjtën kohë, që “përmendja e robit nga Allahu është më e madhe se përmendja e Allahut nga ana e robit”. Prandaj te namazi është përfitimi më i madh për t’iu afruar Zotit.

Përgatitja për namaz

Për zbatimin e përkryer të një adhurimi të madh si namazi, sigurisht që është nevoja e përgatitjes së përkryer për të. Për shembull, në hadithet profetike, duke treguar se si duhet



të jetë namazi i pranueshëm, së pari porositet:

“Kush merr abdest mirë e bukur...” (Muslim, Taharet, 17)

Sepse namazi është i ndërthurur me bukurri natyrore dhe jetësore. Lidhur me pohimin e dobisë së abdestit të vetë dijshtëm të marrë si përgatitje për abdest nga ata që e kanë rrokur kuptimin e kësaj ideje, sa bukur që e shpreh përgatitjen për namaz në kuptimin e plotë të fjalës rrëfimi (rivajeti) mbi Imami Adhamin mbi ndjerjen e derdhjes së mëkateve së bashku me ujin e abdestit! Është e njohur aftësia parashikuese e Imami Adhamit mbi këtë çështje. Ai i thotë një të riu që po merrte abdest:

“O bir, lëri këto e këto gjynahe!..”

I habitur, i riu e pyet:

“O imam, e ku e di ti se i kam bërë këto gjynahe që po thua?”

Imami Adhami i përgjigjet:

“Nga uji i abdestit që po merr, o bir!..”

Nga ana tjetër, ka një rëndësi shumë të madhe kujdesi për përdorimin e misvakut ose



të pastrimit të dhëmbëve para namazit, që është një nga sunnetet jo fort të përmendura. Profeti ﷺ thotë:

“Për nga virtyti, namazi i falur pasi të jetë përdorur misvaku është shtatëdhjetë shkallë më i vyer se namazi i falur pa përdorur misvak.” (Ahmed b. Hanbel, Musned, VI, 272)

“Misvaku është edhe pastrues, edhe fitues i pëlqimit të Zotit.” (Buhari, Savm, 28)

Dihet se namazi, ku ka tekbir, tehlil, tesbih dhe kiraat, është adhurimi ku fjala merr pjesë nga kreu në fund. Nga ky këndvështrim, është e qartë se pastrimi i gojës (duke nisur me pastrimin e dhëmbëve) që është mjedisi i shfaqjes dhe artikulimit të atyre këndimeve të larta, do të jetë pretekst i sigurimit të qartësisë dhe delikatesës të fjalët si dhe i qetësisë dhe kënaqësisë së zemrës.

Megjithëse dhëmbët pastrohen si me misvak, ashtu dhe me pastë dhe furçë dhëmbësh, në përdorimin e misvakut ka shumë dobi shëndetësore që janë bërë të njohura sot. Ashtu siç pohohet në hadithet profetike, misvaku ka, pa dyshim, shumë dobi duke nisur



që nga parandalimi i krimeve të dhëmbëve
dhe shqetësimet e stomakut.

Një i sëmurë i shumëvuajtur e tregon kë-
shtu se si ka vuajtur nga rënia e dhëmbëve
dhe, pastaj, nga shërimi prej kësaj sëmund-
jeje:

Kur vura re se dhëmbët nisën të më binin, shëtita doktor më doktor dhe s'lashë pastë dhëmbësh pa përdorur. Më në fund, një mik më këshilloi të përdorja misvak duke më thënë se kishte dobi të veçanta. Kurrë më parë s'pata përdorur misvak. Dhe nisa të përdor menjëherë edhe ngaqë e kisha humbur shpresën në gjëra të tjera. Pa shkuar shumë, si një favor hyjnor, dobësimi dhe rënia e dhëmbëve m'u ndal. Që atëherë, nuk kam hequr dorë kurrë nga misvaku.



Njëra prej çështjeve të veçanta të përgatitjes për namaz është, mbështetur në hadithin e mëposhtëm, kuptimi i rëndësisë së njohjes veç e veç se cilat gjëra janë në abdest farz, e cilat, sunnet si dhe cilat gjëra janë në namaz farz, vaxhib dhe sunnet:

“Një veprim (adhurim) i paktë por me dije është më i çmuar se një veprim (adhurim) i shumtë por me injorancë!” (Fedaili A’mal, 299)

Veçanërisht, ashtu siç pastrojmë me anë të abdestit për namaz organet e jashtme, duhet edhe të përpiqemi të bëhemi gati për namaz të pastër prej mëkateve duke hedhur tej nga zemra zilinë dhe ndyrësitë e tjera moralo-shpirtërore. Duhet të jemi syçelë e të tregohemi të zgjuar ndaj hileve të stolisura dhe kurtheve të shejtanit dhe njerëzve me tipare shejtanore që do të na bëheshin pengesë për këtë pastrim.

Shprehjen Kuranore, **“Pastroje rrobën”** (Mudeththir, 4), njohësit e kulturës morale e shpirtërore (arif) e kanë shpjeguar dhe praktikuar kështu:

“Për namazin, që do të thotë dalje para Allahut, pastroje dhe mbaje pastër edhe dukjen, edhe botën tënde të brendshme, pajisu me moral të bukur!”

Respektimi, në këtë drejtim, i hadithit profetik, *“Hollojini belin dhe barkun për*



namaz” (Xhamius Sagir), është, përsa i përket përgatitjes për namaz, pretekst prehjeje për zemrat dhe dëshirë për namaz.

Çështja e parë për të cilën aludohet në këtë hadith, është ruajtja nga prekja në haram, kurse e dyta, ngrënia e përkorë për të mos e mbushur stomakun gjersa trupi të marrë përmasa të rënda.

Kushti i pranimi të namazit: Përshpirtshmëria (hushu)

Anën e jashtme të namazit e rregullon shkenca e së drejtës (fikh). Një namaz pa një rregullim të tillë është i pamundur. Ndërkaq, namazi larg përshpirtshmërisë, me një zemër të hallakatur, nuk mund të jetë i pëlqyeshëm, i konsideruar. Për rrjedhojë, vetëm kur të bëhen bashkë rregullat juridike që rregullojnë anën formale të namazit me rregullat moralo- shpirtërore që stolisin (tezjin) botën e ndjenjave, mund të falet një namaz i pranueshëm dhe i konsiderueshëm. Stolisja e botës ndjesore, ndërkaq, bëhet e mundur me anë të realizimit të të fshehtës së pastrimit (tezkije) të urdhëruar në Kuran:



“Kush e pastron vetveten, egon, ka shpëtuar.” (A’la, 14)

Ky edukim moralo-shpirtëror është një veçanti me një rëndësi shumë të madhe për namazin. Kështu, Kurani, ndërsa nuk përqëndrohet mbi farzet, sunnetet dhe numrin e reqateve të namazit, shprehet në mënyrë të posaçme dhe të përsëritur mbi rëndësinë e përshtpirtshmërisë (hushu), sinqeritetit (ihlas) dhe qetësisë (huzur) dhe për vazhdimësinë e kësaj gjendjeje edhe në tërë jetën. Atëherë, ndjenjat, etika dhe përsosmëria përkatëse e aspektit moralo-shpirtëror të namazit janë çështja më e rëndësishme që duhet të respektojë ai që fal namaz. Në Kuran thuhet:

قَدْ أَفْلَحَ الْمُؤْمِنُونَ. الَّذِينَ
هُمْ فِي صَلَاتِهِمْ خَاشِعُونَ

“Besimtarët që falin namaz me përshtpirtje, me të vërtetë kanë shpëtuar!”

(Mu’minun, 1-2)

Hadithi profetik thotë:

“Kush merr abdest mirë e bukur, e fal namazin në kohë, i plotëson rukutë dhe



sexhdet duke i bërë të gjitha këto me përshpirtshmëri, kryen një namaz që lartësohet si një dritë e bardhë dhe e shkëlqyer dhe atij i thuhet:

“Siç më respektove mua, të mbrojtë Allahu edhe ty!”

Dhe kush nuk merr abdest mirë e bukur, nuk e fal namazin në kohë, nuk i plotëson rukutë dhe sexhdet dhe lë mangut në përshpirtje, namazi i tij që lartësohet si një send i zi e i errët, i thotë:

“Siç më humbe mua, të humbtë Allahu ty!”

Dhe kështu gjersa, pasi të shkojë gjer ku të dojë Allahu, të mblidhet rrotull si një paçavure e t’i përplasit syve njeriut!”
(Taberani)

*

Bahaeddin Nakshibendin e pyetën:

“Si e arrin njeriu përshpirtshmërinë në namaz?”

Ai u përgjigj:

“Me këto katër gjëra:



1. Me kafshatë hallall.
2. Duke iu shmangur indiferentizmit në abdest.
3. Duke shqiptuar tekbinin e parë, ta mendojë veten se ndodhet para Zotit.
4. Të mos e harrojë kurrë Zotin edhe jash-të namazit, domethënë, gjendja e qetësisë, prehjes dhe largimit nga vanitetet në namaz ta vazhdojë edhe pas tij.”



Aq e rëndësishme është përsëritshmëria në namaz, saqë njeriu trajtohet mirë në raport të drejtë me të. Në hadithet profetike thuhet:

“Pasi personi ta mbarojë namazin, nga e mira (thevab) e namazit atij i jepet ose një e dhjeta, ose një e nënta, ose një e teta, ose një e shtata, ose një e gjashta, ose një e pesta, ose një e katërta, ose një e treta, ose gjysma...” (Ebu Davud, Nesai)

Domethënë, njeriu fiton mirësi nga namazi vetëm nëse e fal namazin në mënyrë të vetëdijshme dhe me kënaqësi.



Falësit e vërtetë të namazit, kur ngrihen për t'u falur, e lidhin zemrën pas Zotit të orientuar kah kryerja e tij siç duhet dhe fitimi i pëlqimit hyjnor, nuk merren me asgjë tjetër veç namazit, shmangen dhe çlirohen prej të gjitha interesave të jashtme dhe e kryejnë namazin mes ndijimeve shpirtërore. I ngulin sytë në vendin e sexhdes dhe, duke ndjerë mjaft thellë se ndodhen nën vëzhgimin hyjnor dhe, brenda një kënaqësie moralo-shpirtërore, pothuajse bien në dalldi.

Kjo gjendje është, pa dyshim, gjendja e njerëzve principiale që kanë arritur të kenë një zemër të kulluar. Domethënë se, në një pamje, përshpirtshmëria është fryt i principialitetit. Sepse principialiteti, duke e bërë njeriun të singertë e të përshpirtshëm, jo vetëm që e ngjit atë para Allahut në nivele tepër të larta, por edhe bëhet pretekst për mbrojtjen hyjnore. Në hadithin profetik është thënë:

“Qofshin të përgëzuar njerëzit principia-
lë se janë dritë e orientimit (nuri hidajet) !
Si pretekst i tyre shkatërrohen intrigat më
të fugishme!” (Fedaili A’mal, 285-286)

Për dobinë moralo-shpirtërore që do të merret nga namazi duke shtresuar në zemër principialitet dhe përshpirtshmëri, duhen respektuar shkurt këto çështje:

1. Prehja e zemrës: Eshtë mbështjellja e zemrës vetëm me atmosferën shpirtërore të lutjeve, këndimit të ajeteve dhe tesbihve, ndërprerja e plotë e preokupacionit për vanitetet (masiva). Sepse zemra e pashkëputur nga lloj-lloj mendimesh dhe preokupacionesh, nuk mundet ta përqëndrojë veten në namaz, privohet nga mundësia për t'u ndodhur para Zotit. Ja, pra, njeriu mund ta arrijë prehjen e zemrës po qe se bëhet bashkë me Zotin duke u shmangur nga ky privim, po qe se merr pjesë përfitimi nga tërësia e kuptimeve të shqiptuara nga gjuha. Kështu, njerëzit e Zotit (ehlullah) i kanë falur në mënyrë të përsëritur jo vetëm namazet e pafalura në përputhje të plotë me rregullat, por edhe namazet e pafalura dot me zemër në prehje.

Ndërkaq, megjithëse kjo gjendje, ky qëndrim i tyre nuk do të thotë se të gjithë janë të detyruar të veprojnë kështu, është një çështje specifike që të tërheq vëmendjen përse i



përket shpjegimit të rëndësisë së prehjes së zemrës në namaz.

Shkaku i prehjes së zemrës është përpjekja (himmet), është dëshira për lartësim moralo-shpirtëror. Përpjekja (himmet) realizohet si rezultat i njohjes së faktit se afria e dëshiruar ndaj Zotit vërtetohet vetëm me namaz.

2. Kuptimi: Kuptimi i gjërave të kënduara e të thëna në namaz. Këndimi duke e ditur kuptimin e gjërave të kënduara, mundësisht në mënyrë të vetëdijshme. Kjo është veçantia më e rëndësishme pas prehjes së zemrës. Dhe kjo bën punën e një ure të madhe për bartjen e gjendjes në namaz edhe në kohët e tjera jashtë tij.

3. Respekt dhe nderim i thellë: Është ruajtja e përsëritshmërisë në qëndrim dhe në ndjenja duke qenë i vetëdijshëm për qenien para Zotit. Është falja e namazit përmes një respekti dhe nderimi të thellë ndaj etikës së namazit. Ky qëndrim, duke e shumëfishuar vlerën e namazit, shërben si ndërmjetësues pranë Zotit në favor të falësit. E thënë ndryshe, ai që fal namaz, përfiton nga paralajmë-



rimi i më poshtëm, për rrjedhojë, në shkallën më të lartë nga namazi:

“Po deshe që namazi yt të të jetë një miraxh, duke menduar për madhështinë e Allahut dhe të mirat e pallogaritshme që të ka dhënë, quaje të metë namazin tënd! Kujdes, mos shih adhurimin tënd për të pandehur se e ke falënderuar Allahun ashtu siç duhet. Edhe vetë Profeti ﷺ, madje, ka shfaqur pendesë duke thënë: “O Zot, më fal se nuk të adhurova ashtu siç duhet!”

4. Tronditje: Është ndjenja e frikës e lindur nga respekti dhe nderiini i thellë. Kjo frikë bëhet pretekst që njeriu ta njohë pozitën e vet dhe madhështinë sublime të Zotit; kështu krijohet serioziteti dhe përkushtimi në namaz. Përkushtimi, besimi i përkushtuar (takva), domethënë frika nga Allahu dhe përpjekja për ta mbrojtur zemrën nga indiferentizmi dhe shkujdesja, është i vetmi faktor ndikues që e lartëson gradën e njeriut para Allahut. Në Kuran urdhërohet:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَاكُمْ



“...Pa dyshim, më i larti ndër ju para Allahut është më i shquari në takva...” (Huxhurat, 13)

Ebu Dheri ﷺ tregon:

“I Dërguari i Allahut kishte dalë një ditë vjeshte jashtë.

Pemëve po u binin gjethet. Ai tha:

“O Eba Dher! Pa dyshim, po qe se një musliman fal namaz vetëm për pëlqim të Allahut (me singëritet dhe përkushtim), të gjitha gjynahet i derdhen si këto gjethet që derdhen prej drurësh.” (Ahmet, Tergib)

5. Shpresë: Duhet patur shpresë. Në namaz, krahas madhështimit të Zotit, shpresimi i pëlqimit dhe mëshirës së Tij dhe bërja e lutjeve, në këtë drejtim, pas namazit, janë nga tiparet e adhuresit. Sepse vetëm tronditja dhe frika e plagos zemrën dhe vjen një çast që e përmbys drejtpeshimin moralo-shpirtëror. Ndërsa shpresa e mënjanon këtë rrezik dhe siguron drejtpeshim në botën ndjesore.

6. Ndjenja e turpit: Kjo është një stoli që i plotëson virtytet e tjera. Njeri që ka turp Zotin, tuhet prej sjelljeve e qëndrimeve të



pahijshme, për rrjedhojë, i dallon të metën, gabimin, harresën, indiferentizmin dhe shkujdesjen në namaz, nuk kapet nga sëmundja për të qenë i sigurtë për aktet e veta, e kupton të fshehtën e hadithit profetik:

“Askush s’duhet që, si pasojë e faljes së gjynaheve me anë të namazit, t’i besojë vetes!” (Fedaili A’mal, 251)

Ja, pra, zgjidhja e vetme për të mos rënë në indiferentizëm duke menduar se mëkatet, sidoqoftë, falen me anë të namazit, është ndjenja e turpit dhe mbrojtja vazhdimisht e edukatës dhe etikës në namaz. Falja është trajtimi që bën Allahu me anë të favorit, bujarisë dhe mëshirës së Tij, është domosdoshmëria imediate e mëshirës së Tij, sepse, fundja, ne që e njohim fare mirë fytyrën e brendshme të adhurimeve tona, e dimë se ato nuk janë të denja për famën e Allahut të Lartë. Vetëm adhurimet e bëra në frymën e një përkorësie të thellë dhe ndjenje turpi duke e njohur këtë të vërtetë i japin mundësi adhuruesit që, me bujarinë dhe begatinë e Zotit, të fitojë mëshirën e Mëshiruesit dhe pëlqimin hyjnor.

Thelbi i të gjitha këtyre çështjeve është ky: personi i cili në namaz nuk e njëson ri-



tmin e trupit me përsheptshmërinë e zemrës, nuk mundet ta rrokë të vërtetën e namazit. Atëherë, duhet bërë përgatitje edhe shpirtërisht, edhe trupërisht për të vërtetën e namazit. Kështu, në hadithin e mëposhtëm, për të mënjeluar faktorët që lëkundin unitetin trup-zemër, për ta mbrojtur mendimin nga shkujdesja, duke mbajtur para sysh cilësitë njerëzore, porositet:

“Kur ngrënia dhe namazi të rastisin në të njëjtën kohë, jepeni ushqimin para namazit!” (Buhari, Muslim)

Lidhur me çështjen e përsheptshmërisë që kërkohet në namaz kur trupi dhe shpirti janë një, dijetarët janë treguar tepër kërkues dhe, duke trajtuar momentet që duhen patur kujdes, kanë pohuar se namazi i tre personave të mëposhtëm të klasifikuar në mënyrë të figurshme e të përmbledhur sipas gjendjeve përkatëse në namaz, nuk është i pranueshëm:

1. Namazi i gjuetarit
2. Namazi i hamallit
3. Namazi i tregtarit



Këtu, me gjuetarin, nënkuptohet personi që gjatë namazit vështron përreth sikur të donte të gjuante diçka dhe me organet e tjera kryen veprime të tjera të pjesshme. Me hamallin nënkuptohet personi i cili, megjithëse e shtrëngon nevoja, fal namaz pa e përsëritur abdestin. Kurse me tregtarin nënkuptohet personi që vazhdon të mendojë për marrëdhëniet materiale edhe në namaz. Këta tre lloj njerëzish, meqë nuk e arrijnë dot prehjen dhe përshpirtshmërinë e kërkuar në namaz, nuk munden t'ia përkushtojnë veten namazit, për rrjedhojë, falin namaz të llojit “justifikim”, gjë që tek Allahu kurrë nuk gjen pranim. Sepse gatishmëria dhe pjesëmarrja e gjymtyrëve të trupit në namaz është nga kushtet e namazit. Kështu, Profeti ﷺ, për dikë që e ka parë që po fërkonte mjekrën gjatë namazit, ka thënë:

“Po qe se në zemrën e këtij do të kish-te përshpirtje, çdo gjymtyrë e trupit do t'i ndodhej në qetësi.” (Tirmidhi)

Me këtë, Profeti ka shprehur domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së përbashkët të trupit dhe zemrës në namaz.

Edhe hadithet profetike si më poshtë mbështeten mbi këtë të vërtetë:

“Kur ndonjëri prej jush ngrihet për në namaz, të mos i lëvizë asnjë gjymtyrë e trupit! Të mos lëkundet e përkundet si çifutët! Sepse qëndrimi i trupit në namaz pa bërë lëvizje është pjesë e namazit të plotë e të patëmetë.” (Tirmidhi)

“Janë shtatë gjëra të shejtanit në namaz (gjëra që I dëshiron shejtani) : gjakrrjedhja nga hunda, dremitja, lëvizshmëria, gogësitja, kruarja, shikimi djathtas-majtas dhe trazimi i diçkaje ose loja me diçka...” (Tirmidhi)

Këto situata e reduktojnë strukturën moralo-shpirtërore të namazit.

Nga ana tjetër është përsheptshmëria në dukje por që mungon në botën e brendshme, përsheptshmëria hipokrite, nga e cila duhet ruajtur!

Fjala e fundit që duhet thënë në diskutimin mbi përsheptshmërinë, është kjo lutje e Ibrahimit që Zoti na e kujton në Kuran me qëllim që të jetë shembull i bukur për ne:



رَبِّ اجْعَلْنِي مُقِيمَ الصَّلَاةِ وَمِنْ ذُرِّيَّتِي ۚ رَبَّنَا
وَتَقَبَّلْ دُعَاءِ

“Zoti im! Më bëj mua ndër ata që vazhdojnë të falin namaz ashtu siç duhet (me singëritet dhe përshpirtshmëri)! Edhe nga fisi im njerëz të tillë krijo! Zoti im, pranoje lutjen time!” (Ibrahim, 40)

Si arrihet përshpirtshmëria në namaz?

Lidhur me kryerjen e namazit ashtu siç duhet, Hatemi Esam thotë kështu:

“Në fillim bëj në formën më të bukur përgatitjet e duhura për namaz. Fute Qaben mes dy vetullave, Siratin vëre nën këmbë, xhennetin merre në anë të djathtë dhe xhehennemin në të majtë! Me idenë se pas shpinës po të pret Azraili për të të marrë shpirtin tënd të ëmbël, duke thënë, “ky namaz është namazi i fundit i jetës sime”, qëndro para Zotit të Gjithësisë tërë frikë dhe shpresë!”



Merr tekbir krejtësisht i vetëdijshëm për përmbajtjen e tij! Këndo Kuran rëndë-rëndë dhe duke e menduar kuptimin e pjesës që këndon! Përkulu (ruku) me thjeshtësi dhe bjer në sexhde me përshpirtje! Trupi të të vazhdojë me ecurinë e natyrshme të namazit, kurse shpirti të të mbetet vazhdimisht në sexhde dhe të mos ndahet asnjë çast nga ai bashkim!..”

Namazi që është miraxhi i besimtarit, është, në të njëjtën kohë, edhe për të marrë, me anë të meditimit të kësaj skene të favorit hyjnor, pjesë përfitimi dhe frymëzimi!

Prandaj, duke falur namaz, duhen bërë përpjekje për të përfituar nga fryma shpirtërore e Tehijjatit që është, për ne, një kujtim miraxhi, i miraxhit si skena më enigmatike e dashurisë së Allahut për Profetin ﷺ dhe e afrimit të tij pranë Vetes. Edhe Fjala e Dëshmisë që këndohet në Tehijjat, me pohimin se ç’pozitë e lartë janë besimi monoteist (tevhid) dhe adhurimi, pohon, në të njëjtën kohë, edhe domosdoshmërinë e përshëndetjes së Profetit ﷺ me paqë e mëshirë (salat dhe selam) kur përmendet emri i tij!



Ja, kjo përmbajtje e namazit është pothuaj si një dritare hyjnore e hapur për zemrat tona për të parë kah e vërteta muhammediane! Nga kjo dritare, ashikët e dashurisë hyjnore i afrohen Zotit me besim dhe dituri dhe, duke vëzhguar të fshehtën hyjnore, sodisin shfaqjet dhe të vërtetat e larta. Nisur nga kjo, pa e kuptuar të fshehtën e përmendjes së emrit të Profetit ﷺ krahas emrit të Allahut me rastin e thënies së Fjalës së Dëshmisë në çdo ndenije të namazit i cili është vetëm një shprehje e kthimit kah Allahu duke u çliruar nga çdo gjë tjetër, është e pamundur të arrihet përsosmëria në besim!

Me të vërtetë, përshëndetjen e Profetit me paqë dhe mëshirë mes entuziasmit dhe ekstazës së besimit si një shfaqje dashurie për të, Zoti ua ka urdhëruar besimtarëve duke sjellë si shembull përshëndetjen e Tij vetë dhe të engjëjve:

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا
الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا



“Pa dyshim, Allahu dhe engjejt e përshëndesin të Dërguarin shumë. O besimtarë! Edhe ju përshëndeteni atë dhe lutuni për të me një nënshtrim të plotë!” (Ahzab, 56)

Ja, pra, ata që adhurojnë dhe falin namaz në një atmosferë të tillë urtësie dhe nënshtrimi, clirohen prej vetes dhe prej cdo gjëje tjetër. Ata e humbin lidhjen me botën dhe me cdo gjë tjetër brenda saj.

Për njerëzit që mund të jenë të aftë për të falur namaz të tillë, poeti Rumi thotë simbolikisht:

“Kur ata sjellin tekbir dhe nisin në namaz, hiqen nga kjo botë si kurbanë e shkojnë.”

Pastaj poeti i bën zë atij që falet:

“Edhe ti, për t’i ndjekur ata, fal namaz duke ndenjur drejt në këmbë si qiriri! Dije se thënia “Allahu Ekber” duke nisur namazin, ka këtë kuptim: “Allahu im! Ne u bëmë kurbanë para Teje! Dhe, me ngritjen e pëllëmbëve te veshët për tekbir, i hodhëm të gjitha gjërat pas krahësh e t’u drejtuam Ty!”

Ashtu sic thua “Allahu Ekber” kur therr kurban, thua edhe kur bën kurban nefsin, egon tënde që e meriton të vritet.



Ato caste, trupi të është si Ismail, kurse shpirti, si Halil Ibrahim. Sapo që shpirti, për t'i prerë dëshirat dhe iluzionet e këtij trupi të majmur, bën tekbir, trupi shpëton prej epsheve e ambicjeve dhe me thenien, në namaz, bismillahi rrahmani rrahim", bëhet kurban e mbaron.

Ata që falin namaz, qëndrojnë, ashtu si në kiamet, të vënë në radhë para Allahut dhe nisin t'u përgjigjen pyetjeve, të japin llogari e të luten.

Qëndrimi në namaz në këmbë duke derdhur lot i përngjan ringjalljes në ditën e kiametit, daljes nga varret, ardhjes në vendgrumbullim dhe qëndrimit në këmbë para Allahut. Ai ka për të të pyetur ty: "Ç'bëre ti gjatë këtij afati që të dhashë? Ç'fitove dhe ç'më solle Mua?"

Qindra mijra pyetje të tilla që ta shumëfishojnë mjerimin kanë për të ardhur atë ditë kur të jesh duke qëndruar në këmbë para Allahut!

Ndërsa qëndron në namaz në këmbë, robi turpërohet nga fjala hyjnore, prandaj përkulet



në ruku. Atij s'i ka mbetur fuqi për të qëndruar drejt. Në ruku ai thotë “subhane rabbijel adhim” duke e madhëruar Zotin e vet dhe duke pohuar madhështinë dhe përsosmërinë e Tij absolute.

Pastaj robit i vjen ferman, dekret prej Zotit: “Ngrije kokën dhe përgjigjiu pyetjeve!”

Robi e ngre kokën tërë turp, por s'mundet të qëndrojë dhe, tërë thjeshtësi e përlulesi, bie poshtë me ballin në tokë.

Zoti e urdheron: “Ngrije përsëri kokën dhe fol se do të të pyes me hollësi për ato që ke bërë!”

Fjala tronditëse e Allahut aq shumë e ka prekur atë, saqë s'i ka mbetur pikë fuqie për të qëndruar në këmbë. Për shkak të kësaj ngarkese, bie në sexhden e dytë. Kurse Zoti i thotë: “Fol, thuaj, të pata dhënë të mira, si i përdore? A falënderove? Të pata dhënë pasuri materiale e shpirtërore, c'fitove me të?”

Robi kthen fytyrën nga e djathta dhe u dërgon përshëndetje shpirtave të profetëve dhe engjejve. Dhe u thote: “O mbreter të kuptimit! Ndërhyni për falje për këtë njeri të



keq! Ky mëkatar ka rënë kokë e këmbë në baltë!”

Profetet i thone njeriut:”Dita e ndihmës dhe shpëtimit kaloi. Në atë botë të kishe kërkuar ndihmë! Kurse ti atje punë të dobishme nuk bërë, adhurime nuk bërë, kohën me gjëra të kota e vrave!”

Pas kësaj, robi e kthen fytyrën nga e majta dhe kërkon ndihmë nga të afërmit. Kurse ata i thonë: “Hesht! Kush jemi ne që të të ndihmojmë ty? Hiq dorë prej nesh dhe përgjigju vetë para Zotit!”

Zemra e njeriut që s’gjen zgjidhje as nga kjo anë, as nga ajo anë, bëhet copë-copë. Me shpresë të prerë prej të gjithëve, hap duart dhe, me qafën të përkulur, i dërrmuar, nis të lutet e të përgjërohet. Dhe thotë: “Allahu im, e preva shpresën prej të gjithëve! Ti je e vetmja strehë për këtë robin Tënd fund e krye! Në mëshirën dhe bamirësinë Tënde të pafundme u mbështeta!”

Dhe Rrumiu që e dallgëzon kështu këtë det përfytyrimi e meditimi, e mbaron përsiatjen e tij të fuqishme e emocionuese duke thënë:



“Shihi këto shenja të këndshme të namazit dhe, duke e kuptuar seriozitetin e kësaj, bindu se pa diskutim që kështu ka për të ndodhur më në fund! Vër mend dhe kujdesu që të përfitosh nga namazi jo vetëm formalisht, por edhe në përmbajtje! Mos u mjafto vetëm të ulësh e të ngresh ballin nga toka sic zogu që mbledh fara, pa ditur gjë për madhështinë e Allahut! Vëri veshin Profetit që thotë se “hajduti më i keq është ai që vjedh nga namazi!” (Hakim, Mustedrek, I, 353)

“Robi e ruan gjendjen e vet të namazit edhe pas mbarimit të namazit. Kështu, të gjithë jetën e kalon me edukatë, me përsëritje, duke e mbrojtur gjuhën dhe zemrën. Kjo është gjendja e të dashuruarve dhe e miqve të vërtetë të Zotit.”

Dhe më tej:

“Namazi, i cili na tregon neve rrugën e drejtë e na largon prej të këqijave, falet në pesë kohë. Kurse të dashuruarit janë vazhdimisht në namaz. Sepse pasioni hyjnor në zemrat e pasionuara, ajo afria dhe ai intimiteti hyjnor zemërpërvëlues as me pesë kohë namaz hesh-ten, as me pesëqind kohë largohen!



Namazi për njeriun e pasionuar pas Zotit i ngjan ujit për peshkun. Ashtu siç nuk jeton peshku pa ujë, edhe shpirti i njeriut të pasionuar nuk mund të gjejë qetësi e prehje jashtë namazit. Shpirtrat e njerëzve të pasionuar pas Zotit janë shumë të etura.

Sado pak që të ndahen të dashurit nga njëri-tjetri, u duket sikur kanë vite që janë ndarë. Dhe kur janë pranë, viti u duket sa një çast. Prandaj ndodh që, meqë i dashuruari pas Zotit e sheh namazin si pretekstin e vetëm për të qenë pranë Tij, ndodhet vazhdimisht në namaz me dëshirën për të qenë pranë Tij. Mijëra reqate të falura i duken si një reqat. Po kështu, edhe sikur të ndahet nga një reqat i vetëm namazi, i copëtohet zemra sikur të kish lënë pa falur mijra reqate!

O ti qenie me mend! Mendja e ka të pamundur ta kuptojë bashkimin në namaz. Vetëm nëse mendja i bëhet kurban të Dashurit dhe ringjallet bota e ndjenjave!”

Ringjallja e botës së ndjenjave ka të bëjë me faktin se kah cila kible orientohet njeriu. Këtë orientim, Rrumiu e bën të ditur kështu:



“Kibleja e mbretërve janë kurora dhe brezi mbretëror, kibleja e njerëzve të shtënë pas interesave dhe dëshirave të kësaj bote, është ari dhe argjendi. Kibleja e njerëzve të shtënë pas formës, është trupi që përbëhet prej uji dhe dheu, kurse kibleja e njerëzve të shtënë pas kuptimit, është shpirti dhe zemra. Kibleja e adhuruesve të përkushtuar janë adhurimet, kurse e indiferentëve, punët e kota. Kibleja e përtacëve është ngrënia dhe gjumi, kurse e njerëzve të vërtetë, ushqyerja me dije e kulturë!

Kibleja e dashnorit, bashkimi pa përndim, kurse e njeriut të pajisur me kulturën fetare e shpirtërore (arif), bukuria e të Madhit. Kiblja e njerëzve të kësaj bote është pasuria dhe posti, kurse i udhëtarit, kërkesat e tarikatit. Kiblja e dëshirës dhe ambicjes është iluzioni, kurse i njerëzve të kënaqur, dorëzania e Allahut.

Dhe dijeni se kiblja kah kthehemi në namaz, nuk është ndërtesa e Qabes, por mjedisi ku ndodhet ajo. Sepse, po qe se ajo ndërtesë bartet për diku tjetër, nuk mund të bëhet më pikë orientimi.”



Për rrjedhojë, duke e kthyer trupin kah Qabeja në namaz, duhet që edhe zemra të kthehet kah Allahu. Sepse kibleja e zemrës është Allahu!

Nga ana tjetër, për realizimin dhe ruajtjen e përshtatshmërisë, duhet që, siç e thotë edhe hadithi profetik, “aktet janë sipas qëllimit.” (Buhari, Bedul Vahj, 1) të veprohet sipas një qëllimi krejtësisht të qartë dhe në përputhje me frymën e namazit, me vetëdijen e namazit përkatës dhe të daljes para Zotit, duke i kontrolluar ndjenjat dhe duke u çliruar prej të gjitha synimeve veç pëlqimit hyjnor.

Me anë të tekbitit, duke e shqiptuar atë saktë, duhet të ndihet në zemër madhështia e Allahut. Duke i ngritur pëllëmbët gjer në veshë, të hidhen pas plotësisht punët e kësaj bote, zemrat duhet t'i mbështjellë vetëdija dhe kënaqësia e ndodhjes para Allahut dhe duhet filluar namazi me gjendjen shpirtërore të daljes prej kësaj bote të vdekshme dhe hyrjes në botën e pavdekshme të ahiretit.

Në qëndrimin në këmbë (kijam), duke e mbajtur shikimin te vendi i sexhdes, duke mos e harruar për asnjë çast qenien para pranisë



hyjnore, duke e bartur zemrën drejt kulmit të ndjenjës së dobësisë, nevojtarisë dhe nënshtrimit para Zotit, të bëhen përpjekje për t'u përfshirë mes grupit të njerëzve të mirë (salih), të lavdëruar me shprehjen, “ç’rob i mirë!”

Në këndimin (kiraat), duke i kënduar ajetet e Kuranit saktë, shtruar dhe duke i dalluar fjalët një e nga një, duhet përpjekur edhe për ta ndjekur kuptimin e tyre e për të menduar mbi atë kuptim për ta kaluar në jetë.

Në hadithin profetik thuhet: “Ai që këndon Kuran, do të thotë se bisedon me Allahun.” Duke u nisur nga kjo, gjatë këndimit të ajeteve, së bashku me gjuhën duhet të jetë e zgjuar, e kënaqur dhe e qetë edhe zemra.

Tesbihet në ruku duhen kënduar me ndjenjë rëndësie e madhështie duke menduar për kuptimin e tyre.

Edhe tesbihet e sexhdes duhen kënduar duke menduar për madhështinë e Allahut. Brenda mendimit dhe ndjenjës së sexhdeja është çasti kur robi ndodhet më afër me Zotin, të bëhet sexhde më shumë me shpirt se sa me trup dhe të përfitohet prej të fshehtës



së thënies, “Bëj sexhde dhe afrohu.” (Alak, 19) Kështu, duke u zhytur në kënaqësinë dhe lumturinë e shijimit të konfidencës së Allahut, duhet jetuar për të arritur përfshirjen në karvanin e atyre që digjen me dashurinë për Allahun të mishëruar në shprehjen, “Refik-i a’la”, “Miku i Madh”.

Në qëndrimin ndenjur (ka’de), ashtu siç u tha edhe më parë, duke hyrë në klimën kuptimore të Tehijjatit, duhet ndenjur me vetëdijen e audiencës hyjnore dhe me qëndrimin lutës e me qafë përkulur.

Në mbarim të namazit, jepet selam, i cili duhet bërë sikur po ndahet me engjëjt djath-tas e majtas gëzimi dhe kënaqësia e madhe e një bashkimi hyjnor të përjetuar nëpërmjet namazit që do ta çojë robin në “Vendin e Paqes” (Darus Selam), pra, në Xhennet.

Po qe se namazi është falur në një mënyrë të pranueshme e të pëlqyeshme në lartësinë e Allahut, përgjigjja për këtë selam, për këtë përsëndetje dhënë engjëjve, do të jetë në këtë botë dhe në jetën e pasme (ahiret), sipas pohimit hyjnor, kështu:



“Selam juve që keni bërë durim (ndaj vështirësive të jetës në rrugën e Allahut dhe për të mos u larguar nga ajo rrugë) **! Sa i bukur është** (si shpërblim) **fundi** (xhenneti) **i jetës suaj në këtë botë!** (Ra’d, 24)



Përshpirtshmëria (hushu), edukata, etika dhe gjendja e konfidencës hyjnore në namaz, për të cilat u fol gjer këtu, nuk janë gjëra që i kapërcejnë mundësitë njerëzore e të paarritshme. Kënaqësia sublime e hyjnore në namaz nuk duhet menduar vetëm si një shprehje që i stolis fjalët dhe si një iluzion. Namazet e falura nga Profeti ﷺ i cili na e ka mësuar namazin neve, janë të një cilësie që i kapërcen këto përshkrime. Edhe namazet e sahabeve të edukuar me edukatën e tij moralo-shpirtërore si dhe namazet e njerëzve të afërt të Allahut (evlijaullah) që kanë ecur e ecin në rrugën e tyre, janë për ne pishtarë ndriçues.

Namazi i të Dërguarit të Allahut ﷺ

Siç rrëfëhet, kur i Dërguari i Allahut ﷺ qëndronte në namaz, nga gjoksi i tij vinte



vazhdimisht një zhurmë ngashërimi si zhurma e mokrrës së dorës kur bluan. Aliu ؑ e tregon kështu një mbresë të tillë lidhur me këtë:

“Në luftën e Bedrit pashë të Dërguarin e Allahut që po falte namaz nën një pemë duke qarë. Dhe ashtu e gjeti mëngjesi...”

(Fedaili A'mal, 299)

Krahas kësaj gjendjeje të zakonshme nga shërimi, herë pas here, gjatë namazit, nga gjoksi i Profetit ؑ dëgjoheshin zëra si zhurma që nxjerr tenxhereja kur zjen.

Aisheja ؓ thotë:

“Kur i Dërguari i Allahut qëndronte në namaz, nga gjoksi i vinte një zë si zjerja e kazanit.” (Ebu Davud, Salat, 157; Nesai, Sehv, 18)

Lidhur me mënyrën e faljes së namazit nga Profeti, Aisheja ؓ theksonte veçanërisht këto:

“I Dërguari i Allahut bisedonte me ne dhe ne bisedonim me të. Por, me të ardhur koha e namazit, bëhej sikur s'na njihte dhe i drejtohej Allahut me tërë qenien e vet...”

(Fedaili A'mal, 303)

Ja, pra, dëshira dhe prirja për të përfituar pjesë nga kjo gjendje sublime në namaz, du-



het të jetë synimi më i madh i zemrës. Edhe nëse përjetimi i përsëritshëm i një gjendjeje të tillë është i pamundur, të paktën duhen bërë përpjekje për të bërë diçka. Me fjalë të tjera, gjendja e Profetit ﷺ në namaze matet me dimensione yjore. Sa më shumë l'i afrohem, aq më shumë marrim frymëzim.

Duhet pohuar edhe kjo që, ashtu siç ndodh që asnjë veprim nuk fiton përsosmëri të menjëhershme, ashtu dhe adhurimet nisin me një formë imitimi sipërfaqësor. Si artisti që arrin të nxjerrë një vepër artistike të përsosur vetëm pas një përvoje të gjatë artistike, edhe përparimi i njeriut në adhurim kërkon kohë. Duke e mbajtur parasysh këtë të vërtetë, ata që ende nuk munden ta falin namazin në mënyrë të përsosur, nuk duhet të tregohen pesimistë, por të vazhdojnë në rrugën e tyre. Ashtu siç duhen situatona tërësi tërësi për të nxjerrë një gram ar, ashtu dhe, për të arritur përsosmërinë në namaz, duhet durim dhe përpjekje.

Për këtë, është e domosdoshme të përjetohet hadithi profetik që thotë:

“Kur të qëndrosh në namaz, fale atë sikur të ishte namazi yt i fundit! Mos e



thua një gjë për të cilën nesër ke për t'u penduar! Hiq dorë nga dëshirimi i gjërave të shkujdesura të njerëzve!" (Ibni Maxhe, Zuhd, 15)

Qëndrimi i sahabeve të përgatitur në ku-vendet e bekuara të Profetit ﷺ dhe i njerëzve të afërt të Allahut që kanë ecur në gjurmët e tyre, janë realizuar gjithmonë brenda përmbajtjes së këtij hadithi profetik.

Namazi i të mëdhenjve të Islamit

Omerin ؓ e pati plagosur me heshtë një adhurues i zjarrit. Ai po humbte gjak pandër-prerë. Pas një farë kohe, Omeri i humbi ndjenjat. Kjo ishte një humbje ndjenjash vdekjeje. Por, kur erdhi koha dhe dikush e lajmëroi në vesh për namaz, erdhi në vete me një vullnet të habitshëm, u ngrit duke thënë se “ai që s’fal namaz, nuk ka vend në islam” dhe u fal. Dhe kështu vazhdoi disa herë.

Kur Aliu qëndronte në namaz, fytyra i zverdhej dhe ai çlirohej nga çdo gjë e kësaj bote, edhe nga trupi i vet, madje. Kur ia patën nxjerrë, ndërsa ndodhej në namaz, shigjetën e ngulur në këmbë gjatë një beteje, nuk pati ndjerë, nuk pati kuptuar asgjë.



Atë e patën pyetur:

“O udhëheqësi i muslimanëve! Pse kur vjen koha e namazit të ndërron ngjyra e fytyrës dhe fillon të dridhesh?”

Ai iu përgjigj:

“Kur vjen koha e namazit, vjen koha e çuarjes në vend të një amaneti që nuk e kanë marrë dot përsipër toka dhe qiejt, që nuk e kanë mbajtur dot malet. Dhe unë nuk e di nëse do të jem në gjendje ta kryejatë pa të metë!”

Kur shokët e Profetit qëndronin në namaz, zemrat ua mbështillte madhështia e Allahut dhe frika ndaj Tij!

Gjatë marrjes së abdestit, Hasanit ﷺ i ndërronte ngjyra e fytyrës. Dikush që e vuri re këtë, e pyeti:

“O Hasan, pse zverdhesh dhe merr frymë kështu kur je duke marrë abdest?”

Ai iu përgjigj:

“Sepse ka ardhur koha për të dalë para Allahut të Madh, zotëruesit të vetëm të fuqisë!”



Kur hynte në faltore, Hasani lutej kë-shtu:

“Zoti im, Robi yt të ka ardhur në derë! Allahu im bujar, robi yt mëkatar ka ardhur tek Ti! Ti i ke urdhëruar robtë e tu të mirë t’ua falin të këqijat njerëzve të këqinj. Sepse Ti je falës dhe bujar. Allahu im, mëshiromë edhe mua dhe falmi edhe të këqijat e mia me bujarinë dhe faljen tënde!”

Edhe Zejnelabidin, kur ngrihej për të marrë abdest, zverdhej dhe, kur do të fillonte të falej, i dridheshin këmbët. Atyre që e pyesnin për shkakun, u përgjigjej:

“A s’dini gjë se para kujt kam për të dalë?”

Një radhë, kur po falej, në shtëpi ra zjarr. Por ai nuk e dalloj këtë. Pasi dha selam, e njoftuan dhe e pyetën:

“Ç’gjë të bëri të mos e kuptosh se po të digjej shtëpia?”

Zejnelabidini u përgjigj:

“Zjarri i ahiretit që i pret njerëzit më bëri të mos e dalloj dot këtë zjarrin e vogël të kësaj bote!”



I tillë qe edhe namazi i Muslim bin Jesarit. Ai po falte namaz në një xhami në Basra. Në këtë mes, xhamia u shemb me një zhurmë të madhe. Kurse Muslim bin Jesari vazhdonte të falej sikur të mos kish ndodhur gjë. Pasi dha selam, e pyetën:

“Faltorja u shemb, kurse ty s’të lëvizi qimja? Ç’është kjo?”

Muslimi ua ktheu me habi:

“Faltorja u shemb? Unë s’paskam marrë vesh gjë!”

Sufjan Sevri kish rënë në një gjendje tërheqjeje të thellë. Shtatë ditë u mbyll në shtëpi. Nuk hëngri e nuk piu. E lajmëruan mësuesin e vet për këtë. Mësuesi i pyeti njerëzit:

“A i dallon kohët e namazit?”

Njerëzit iu përgjigjën:

“Sigurisht, i ndjek plotësisht ato dhe e fal namazin rregullisht.”

Atëherë, mësuesi tha:

“Lavdi Allahut që nuk ia ka lëshuar shejtanin në qafë!”



“Fala një namaz iqindie pas Zunun Misriut. Kur ai rob i shenjtë e i bekuar tha “Allahu Ekber”, emri i Allahut ushtroi një ndikim të tillë mbi të saqë nuk i mbeti më shpirt në trup. Ai ngriu. Kurse kur tha “Ekber”, nga tronditja e tekbitit të tij zemra ime u bë cope-copë!”

Kur Amir bin Abdullah qëndronte në namaz, priste çdo lloj marrëdhënieje me botën e jashtme dhe asgjë nuk mundej t’ia prishte përshtirjen e namazit. Ai thoshte:

“Në namaz, më mirë pranoj të më ngulet një shigjetë në trup se sa të më tërheqin vëmendjen fjalët dhe veprimet e të tjerëve!”

Ata që sot nuk mundin të hyjnë në klimën e namazit të falur prej shokëve të Profetit (as’habe) dhe pasuesve të tyre (tabiinë), kanë mbetur aq larg nga shija dhe kënaqësia e atij namazi, saqë arrijnë, tani, edhe të dyshojnë, madje, mbi vërtetësinë e cilësisë së lartë të tij. A nuk mendojnë këta se, kur i zë mëngjesi ata që dëfrehen me anë kënaqësish të ulta e boshe, pse të mos i zërë zemrat e kënaqura me kënaqësi shpirtërore pakrahasimisht të larta ndaj të parave? Vetëm se është mjaft e vështirë t’ua shpjegojë këtë gjë atyre që s’e



njohin këtë shijë dhe kënaqësi! Njerëzit e rënë në indiferentizëm besojnë se para kënaqësisë së kuvendit me temë dashuri të përkohshme e të vdekshme çdo gjë harrohet, por nuk e kuptojnë dot kënaqësinë e namazit në nivelin e kuvendit me Zotin që është i dashuri më i madh! Ç'indiferentizëm i madh e ç'mungesë e hidhur!

Namazi i vërtetë e ngre njeriun në nivelin e njohjes ndjesore të Zotit, e falënderimit ndaj Tij dhe të adhuresit të singertë. Prandaj, kryerja e namazit u vjen e lehtë njerëzve besimtarë me zemrën plot me dashurinë dhe afërsinë për Zotin, u jep atyre mundësi të përjetojnë një gjendje kënaqësie krejt të veçantë. Kështu ata nuk ndahen qoftë edhe një çast nga namazi formalisht dhe esencialisht.

Pasi niste namazin, Vejsel Karaniu nuk donte të ndahej dhe e ndërpriste vetëm për nevoja njerëzore. Një radhë, dikush që kishte ardhur për t'i bërë vizitë, priti shumë gjatë që ai ta mbaronte namazin. Por, pasi pa se Vejsel Karaniu pas çdo selami ia niste përsëri namazit, foli me vete:



“O zemër, i erdhe këtij zotërie për vizitë për të përfituar prej tij. Ja dhe ai: i kredhur në bisedën e tij të pafundme! Ç’është nevoja për fjalë? Po qe se mund të nxjerrësh mësimin e duhur nga kjo që pe, të mjafton për të gjithë jetën!”

Vetëm ajo që pa, i shërbeu vizitorit si një bisedë shumë e begatë edhe pse pa fjalë e në heshtje! Kështu, njeriu, në përfundim të këtij reflektimi dhe ngjyrimi shpirtëror, u largua pa u takuar dhe biseduar, por me zemrën e mbushur plot kënaqësi e lumturi!

Kurse për ata që janë të privuar nga kjo gjendje, Zoti thotë kështu:

“Pa dyshim, ai (namazi) u vjen i rëndë të tjerëve veç atyre që kanë frikë Allahun.”

(Bakara, 45)

Këtu duhet bërë e qartë edhe kjo e vërtetë:

Edhe në mos qoftë e mundur të arrihet niveli i lartëi arritur në namaz nga të afërmit e Allahut (ehlullah) dhe njerëzit e mirë (salih), duhet treguar sinjeritet dhe duhen bërë përpjekje për të falur një namaz cilësor me aq



sa na e lejon kapaciteti i zemrave tona. Disa herë shejtani, duke i thënë njeriut, “më mirë të mos falesh fare se sa të falësh një namaz të tillë të shkujdesur”, ia lëkund gjykimin dhe vendosmërinë dhe e hedh nga rreziku në rrezik, e lëshon në kurth. Për rrjedhojë, një mendim i tillë bëhet shkak për shkatërrim. Duhet menduar se është më mirë të falesh kështu se sa të mos falesh fare. Ndryshimi është i madh. Ai që s’falet është vazhdimisht me dëm. Kurse ai që fal namaz qoftë edhe me të meta, mund të vijë një ditë që, duke fituar favorin hyjnor, të falë një namaz të pranueshëm e të pëlqyeshëm te Zoti. Sikur qoftë edhe një herë në jetë të mundim të falim një namaz të tillë duke u çliruar nga bota, kemi fytyrë t’i drejtohem Zotit!

Namazi farz i pesë kohëve

Farzet, detyrimet fetare të formës së pre-rë, i janë bërë të ditura Profetit ﷺ nëpërmjet Xhebrailit ﷺ. Kurse namazi farz i pesë kohëve i është ofruar si dhuratë Profetit drejtpërdrejt nga Zoti natën e miraxhit. Në fillim namazi farz ishte pesëdhjetë kohë. Ndërkaq, Profeti u takua në qiell me Musanë, i cili i tha:



“O i Dërguari i Allahut, edhe unë e provova këtë para teje me të bijtë e Israelit. As ummeti yt nuk ka fuqi të përballojë pesëdhjetë kohë!”

Duke u mbështetur në këtë këshillë, atë natë, Profeti iu lut Zotit pesë herë. Më në fund, numri i namazeve farz zbriti në pesë kohë.

Musai i tha sërish Profetit:

“As për këtë s’do të kenë fuqi!”

Kurse Profeti e kundërshtoi:

“Kam turp të kërkoj prej Zotit tim një zbritje tjetër!”

Dhe namazi farz mbeti në pesë kohë.

Ndërkaq, Zoti, duke treguar mëshirë në saje të lutjes së Profetit ﴿﴾, krahas uljes së namazit në pesë kohë, i dha atë natë miraxhi të dërguarit të Tij edhe këtë myzhdë:

“O i Dërguari im! Te Unë fjala kurrë s’lëviz! Për këtë namaz pesë kohësh ti do të marrësh shpërblim në pesëdhjetë kohëve namaz!” (Ibni Maxhe, Ikametus salat, 194)

Mbi namazin pesë kohësh, i Dërguari i Allahut ﴿﴾ i drejtohet kështu ummetit të vet:



“Allahu i Lartë urdhëroi: “Për ummetin tënd caktova pesë kohë namaz farz. Unë kam dhënë një fjalë: kush i fal këto namaze në kohën e vet, do ta çoj në xhennet. Kurse për ata që nuk i mbajnë ato namaze, nuk ka asnjë premtim!” (Ibni Maxhe, Ikametus salat, 194)

Në një hadith tjetër thuhet kështu:

“Allahu ua ka bërë farz (detyrim) robve pesë kohë namaz. Atij që i fal këto namaze plotësisht pa i nënvleftësuar, Allahu i ka dhënë fjalën se do ta çojë në xhennet. Kurse për atë që i nënvleftëson ato dhe i fal me mungesa, nuk ka ndonjë premtim të tillë. Po të dojë, Allahu e ndëshkon atë, po të dojë, e fal.” (Ibni Maxhe, Ikametus salat, 194)

Për t’ua shpjeguar shokëve përmbajtjen dhe rëndësinë e pesë kohëve namaz, Profeti i pyeti kështu:

“Sikur para derës së dikujt të kalojë një lumë dhe ai të lahet aty pesë herë në ditë, a mbetet më papastërti te ai?”

Shokët iu përgjigjën:

“S’mbetet asnjë papastërti, o i Dërguari



Atëherë Profeti u tha:

“Kështu ndodh edhe me pesë kohët namaz. Me to Allahu i fshin të gjitha gjynahet!” (Buhari, Mevakit, 6)

Në një hadith tjetër, Profeti ka dhënë këto lajme të mira: *“Për sa kohë që njeriu ruhet nga gjynahet e mëdha, pesë kohë namaz dhe dy xhuma i dëmshpërblejnë të gjitha gjynahet e vogla të”bëra mes tyre.”* (Muslim, Taharet, 14)

“Po qe se një musliman, kur të vijë koha e namazit, merr abdest mirë e bukur dhe e fal namazin plotësisht dhe me tërë shpirtin, ky namaz, nëse ai nuk bën ndonjë gjynah të madh, i dëmshpërblen të gjitha gjynahet para tij. Kjo është kështu gjithmonë.” (Muslim, Taharet, 7)

Duhet pohuar edhe kjo që secili prej namazeve farz të pesë kohëve përmbajnë rëndësi dhe vlera të veçanta. Edhe shpërndarja e tyre në kohë të caktuara të ditës e natës përmban një mijë e një urtësi e dobi si për trupin, ashtu dhe për shpirtin e tij. Prandaj, nuk duhet treguar indiferentizëm për kryerjen e secilit namaz me një kujdes dhe interesim



të veçantë si dhe me gjithë zemër. Allahu i
Lartë urdhëron:

“Madhërojeni Allahun kur bie mbrëmja dhe në mëngjes herët, në fund të ditës dhe kur të vijë mesi i ditës. Në qiej e në tokë, falënderimi i përket vetëm Atij!” (Rum:17-18)

Abdullah ibni Abbasi عليه السلام, duke pohuar se këto dy ajete përmbajnë pesë kohët namaz, thotë kështu:

“Shprehja “në mëngjes herët shënon namazin e agimit; shprehja “mesi i ditës”, shënon namazin e mesditës; shprehja “në fund të ditës” shënon namazin e pasditës (iqindisë); kurse shprehja “kur bie mbrëmja” shënon namazet e mbrëmjes dhe jatsisë.”

Veç këtyre, edhe në ajete të tjera ka aluzione dhe urdhra të ndryshme mbi namazet.

Mbi rëndësinë e pesë kohëve namaze
farz, Sefiriu thotë kështu:

“Atyre që e lënë namazin e agimit, engjëjt u thonë: “O mëkatar i madh!”

A tyre që e lënë namazin e mesditës, u thonë: “O të dështuar!”

Atyre që e lënë namazin e pasditës, u thonë: “O të ulët!”

Atyre që e lënë namazin e mbrëmjes, u thonë: “O mosmirënjohës!”

Atyre që e lënë namazin e jatsisë, u thonë: “O i humbur!”

Nga ana tjetër, edhe për sunnetet e namazeve farze duhet treguar kujdes dhe këmbëngulje për t'i kryer pa përtesë e plogështi. Sunnetet në fjalë, si plotësues të namazit të kohës përkatëse, janë praktikuar nga vetë Profeti. Një pjesë rrëfimesh (rivajet) mbi këtë çështje janë kështu:

“Sunneti dyreqatesh i agimit është më i dobishëm se bota dhe se të gjitha qeniet që ndodhen në botë!” (Muslim, Salatul musafirin, 96)

“Pejgamberi ﷺ falte katër reqate namaz para farzit të drekës e dy reqate pas tij.” (Tirmidhi, Xhuma, 66)

“E mëshiroftë Allahu atë që fal katër reqat (sunnet) para iqindisë!” (Tirmidhi, Salat, 201)

“Nxitoni të falni dy reqatet pas namazit të mbrëmjes sepse ato dy reqate, së bashku me farzet, ju ngjitin lart!” (Rezin)



Lidhur me sunnetin e parë të namazit të jatsisë merret për bazë hadithi profetik si më poshtë:

“Mes çdo ezani dhe kameti ka namaz.”

(Buhari, Ezan, 16)

Kurse sunneti i fundit dyreqatesh i jatsisë thuhet se ësh. të një prej sunneteve që dihen se janë falur nga Profeti gjatë gjithë jetës.

Një prej çështjeve më të rëndësishme të namazit është edhe falja e tij në kohë. Sa herë që e kanë pyetur Profetin se cila është më e çmuara e punëve, është përgjigjur:

“Namazi i falur në kohë!” (Buhari, Mevakitus

salat, 5)

Koha për të cilën bëhet fjalë këtu, është koha nga njëri namaz në tjetrin. Megjithëkëtë, më e mira e të mirave është falja e namazit në çastin e parë kur të ketë hyrë koha e tij. Në hadithin profetik thuhet:

“Allahu i Lartë është i kënaqur me ata që falen porsa të hyjë koha e namazeve. Kurse ata që falen në fund të kohës, i fal.”



Përveç namazeve farz të pesë kohëve është edhe një namaz tjetër, namazi i xhumasë. Ndërsa diskutimi mbi të është shumë i gjatë, ajeti i mëposhtëm është i mjaftueshëm për të kuptuar rëndësinë e tij:

“O ju që keni besuar! Kur të thirreni (kur të këndohet ezan) ditën e xhuma për namaz, lëreni shitblerjen dhe vraponi menjëherë për ta përmendur Allahun! Sikur ta dinit, kjo është më e dobishme për ju!”
(Xhuma, 9)

Namazet suplementare (nafile)

Në një hadith të shenjtë, Zoti urdhëron:

“Atij që tregon armiqësi ndajrobil tim lë mirë, edhe unë i shpall luftë. Ajo që më pëlqen më shumë mes gjërave që e afrojnë njeriun pranë meje, është zbatimi prej tij i gjërave që ia kam bërë lë detyruara (farz). Krahës kësaj, robi vazhdon të më afrohet mua me adhurime nafile dhe, më në fund, fiton dashurinë time. Pasi ta dua atë, unë bëhem veshi i tij që i dëgjon, syri që i sheh, dora që i kap, këmba që i ec... Po të më kërkojë një gjë, ia jap, po të më kërkojë



mbështetje, e fus nën mbrojtjen time dhe e mbroj. Në gjërat që bëj, unë s'jam lëkundur aq shumë sa ç'jam lëkundur në marrjen e shpirtit të robit tim besimtar: po që se ai s'e do vdekjen, edhe unë s'e dua atë gjë që s'e do ail...” (Buhari, Rikak, 38)

Nisur nga kjo, njerëzit besimtarë, përveç farzeve, falin edhe namaze të tjera si duke dalë në rrugë, në çaste frike, kur kanë ndonjë nevojë, natën dhe në kohë të tjera në përputhje me sunnetin e Profetit ﷺ. Ata i përkasin grupit të njerëzve të përshkruar nga ajeti:

“...Në fytyrat dhe ballët e tyre janë shenjat e sexhdes...” (Fet'h, 29)

Për ta, namazi është një emocion me të cilin s'kanë të ngopur. Dhe namazet nafile janë për vazhdimin e kësaj gjendjeje mosngopjeje. Veçanërisht Profeti ﷺ, megjithëse s'kishte asnjë mëkat, falte natën namaz gjersa t'i enjteshin këmbët dhe këndonte Kuran gjersa ta linin fuqitë. Kështu që, as namazet farze nuk përbëjnë pengesë për namazet nafile, as namazet nafile nuk përbëjnë pengesë për namazet farze. Në të kundërt, namazet nafile shërbejnë për të mbështetur dhe përforcuar



namazet farze. E rëndësishme është përpjekja për t'i kryer të gjitha ashtu siç duhet.

Në hadithin profetik thuhet:

“Puna e parë për të cilin do t'i kërkohet llogari njeriut ditën e kiametit, është namazi. Po qe se namazi i tij është i mirë e i rregullt, ai ka shpëtuar dhe ka arritur sukses. Po qe se namazi i tij është i pavlerë, personi ka humbur dhe ka pësuar disfatë. Po qe se në namazin farz shihet ndonjë mangësi, Allahu i Lartë do të urdhërojë:

“Shihni, a ka në namazet nafile të robit tim ndonjë gjë për ta plotësuar mangësinë në farzet?”

Kështu do të ndodhë edhe me punët e tjera.” (Tirmidhi, Salat, 188)

Atëherë, thënia, “farzet janë të mjaftueshme, mjafton që t'i kryejmë në rregull”, është një paqartësi e madhe dhe një indiferentizëm i madh.

Është e pamundur që farzet të kryhen plotësisht dhe pa të meta si dhe në atë mënyrë që të jenë të pranueshme në lartësinë e Allahut! Sado kujdes që të tregojmë, sigurisht



që do të kemi në namaz mungesa, të meta dhe raste të largimit të tyre nga niveli i pranueshmërisë të Zoti.

Prandaj, për t'i plotësuar këto mangësi, s'ka mundësi tjetër veç nafileve. Meqë një farz i falur një herë nuk mund të përsëritet më, paraqitet nevoja e plotësimit me nafile. Por kjo s'duhet të kuptohet si nënvleftësim i farzeve për t'u marrë me nafilet. Duhet pohuar se as preokupimi me farzet duke lënë mënjanë nafilet dhe as preokupimi me nafilet duke lënë mënjanë farzet s'është i drejtë. E drejtë dhe me vend është që, krahas farzeve, edhe nafilet të falen, sa të jetë e mundur, me qetësi dhe kënaqësi.

Praktika e Profetit ﷺ dhe e shokëve të tij në këtë fushë është e vetmja vijë orientuese. Nga ana tjetër, nuk është i drejtë qëndrimi i atyre njerëzve që kanë namaze të pafalura (kaza), që falin kaza vetëm farzet duke i lënë nafilet. Sepse kazatë mund të falen në çdo kohë të ditës veç kohëve mekruh. Ndërkaq, meqë disa namaze nafile si i pasmesnatës (tehexhahud), i lindjes së diellit (ishrak), i sillës (i paraditës), i pasnamazit të mbrëmjes



(evvabin), janë të lidhura pas kohëve të caktuara, për kryerjen e tyre duhet të sillemi me tejpmësi.

Rabia bin Ka'b el Eslemi ؓ thotë:

“Netët i kaloja me të Dërguarin e Allahut ﷺ. I sillja ujin për abdest, ia plotësoja nevojat që mund të kishte. Një ditë më tha:

“Kërko ç'të duash!”

Unë i thashë: “Dua të jem bashkë me ty në xhennet!”

“Tjetër veç kësaj, s'do?” - më pyeti.

Unë iu përgjigja: “Vetëm këtë!”

“Atëherë, më ndihmo mua duke falur shumë namaz për veten tënde!” (Muslim, Salat, 226)

Në një hadith tjetër profetik thuhet:

“Robi nuk i afrohet dot Allahut me një gjë më të lartë se sexhdet e fshehta. Domethënë, me namazet nafile të falura në shtëpi, të cilat e afrojnë me Allahun më shumë se cdo gjë tjetër!” (Ibni Mubarek)

Sakiki Belhi thotë:

“Pesë gjëra kërkuam, në pesë vende i gjetëm:



1. Begatinë e rizkut, në namazin e sillës.
2. Dritën e varrit, në namazin e pasmesnatës (tehexh-xhud).
3. Përgjigjen e pyetjeve të Munker-Nekirit, në këndimin e Kuranit.
4. Kalimin e lehtë të urës së Siratit, në agjërim dhe sadaka.
5. Hijen e Arshit, në përmendjen, dhikrin e Allahut në vetmi.

Ka namaze të ndryshme nafile. Njohuri për këto jepen gjerësisht në librat e të drejtës islame (fikh). Po që se prekim disa prej atyre më të rëndësishmeve, mund të flasim për këto:

Namazi i sillës ose i paraditës (duhá)

Në hadithin profetik thuhet:

“Njëri prej jush ngrihet në mëngjes në një gjendje sipas së cilës duhet të japë sadaka për secilin prej gjymtyrëve. Çdo tesbih (subhanallah) është një sadaka; çdo tahmid (elhamdulilah) është një sadaka; cdo tehlil (la ilahe il’lallah) është një sadaka;



çdo tekbir (Allahu Ekber) është një sadaka. Urdhërimi për të mirë (maruf) është një sadaka; ndalimi nga e keqja (munker) është një sadaka. Ja, pra, namazi dyreqatesh i sillës (duha) i plotëson të gjitha këto.” (Muslim, Salatul Musafirin)

Aisheja  thotë:

“Unë e pata parë një herë të Dërguarin e Allahut të falë namazin e duhasë dhe kurrë pastaj nuk e lashe pa falur!” (Buhari, Muslim)

Namazi i pasmbrëmjes (evvabin)

Në hadithin profetik thuhet:

“Namazi i falur në kohën mes mbrëmjes dhe jatsisë është namazi i atyre që kthehen (evvabin) kah Alla-hu!” (Ibni Mubarek, er-Rakaik)

Namazi i respektit për faltoren (tahijjetul mesxhid)

Profeti  porosit:

“Kush prej jush të hyjë në faltore, para se të ulet, të falë dy reqate namaz.” (Buhari, Salat, 60)



Namazi i teravive

Aisheja ﷺ thotë:

“Dobësia që ka treguar i Dërguari i Allahut për namazin gjatë ramazanit, nuk e ka treguar asnjë muaj kërkesat materiale e shpirtërore, duhet t’i lutet Zotit me anë të namazit, Profeti ﷺ thotë:

“Po qe se dikush ka një kërkesë për Allahun ose për ndonjë njeri tjetër, në fillim të marrë abdest dhe të falë dy reqate namaz. Pastaj ta falënderojë dhe lavdërojë Allahun. Pastaj të lutet për paqë e mëshirë (salat dhe selam) për Profetin. Pastaj të këndojë këtë lutje: “Nuk ka zot tjetër veç Allahut të butë e bujar! Madhëruar qoftë Allahu, Zoti i arshit të lartë! Lavdi Allahut, Zotit të botëve!

Allahu im, prej teje i kërkoj gjërat që më sjellin mëshirën tënde, që bëjnë të më falen mëkatet, arritjen e të gjitha të mirave dhe shpëtimin prejçdo mëkati!

Allahu im, falmi mëkatet, kthemi hidhërimet në gëzim, plotësoni të gjitha nevojat, ato që kanë miratimin tënd, o më mëshiruesi i mëshiruesve!” (Tirmidhi, Vitr, 17)



Namazi i natës dhe tehexhhud

Te Allahu, çdo kohë ka një veçori më vete. Ndërkaq, disa kohë kanë më shumë vlerë se sa kohët e tjera, prandaj edhe vlerësimi i tyre ashtu siç duhet është shumë i rëndësishëm. Njëra prej këtyre kohëve është nata për të cilën flitet në mënyrë të posaçme në ajetet Kuranore dhe hadithet profetike.

Vlerat që i ka dhënë Zoti natës dhe të fshehtat e saj janë të panumërta. Në lidhje me këtë, sekreti i betimit të Allahut në Kuran si më poshtë është një dritare hyjnore për njohjendhe për zemrën tonë që të vëzhgojë shumë të vërteta:

“Betohem në natën dhe në gjërat që ndodhen në të.” (Inshikak, 17)

“Betohem në natën kur bie heshtja!..”
(Duha:2)

Nata është koha kur, duke e braktisur shtratin e butë e të ëmbël vetëm e vetëm për pëlqimin e nderuar të Allahut të Lartë, njeriu mbështet kokën me dashuri dhe passion në prehjen hyjnore. Prandaj, namazet



e falura natën megjithëse për këtë nuk ka ndonjë detyrim, kanë rëndësi të madhe përsa i përket afërsisë ndaj Allahut. Nisur nga kjo, sa e fuqishme të jetë në zemra dashuria dhe pasoni hyjnor, në atë masë është edhe prirja ndaj namazeve të natës. Mund të thuhet se namazi i natës bart cilësinë e një takimi dhe bisede me të dashurin. Të jesh zgjuar kur të gjithë flenë, do të thotë të hysh në klimën paqësore të Qenies Transcendentale (Mevlai Muteal), të marrësh pjesë në kuvendin e Tij të dashurisë, mëshirës dhe paqes!

I Dërguari i Allahut ﷺ falte natën namaz gjersa t'i enjteshin këmbët. E patën pyetur atë:

“O i Dërguari i Allahut, megjithëse Allahu, në suren “Fetih”, ka bërë të ditur se të ka falur plotësisht, pse e mundon kaq shumë veten?”

Ai qe përgjigjur:

“A s’duhet të jem një rob falënderues?”

(Buhari, Tehexhxhud)



“Namazi më me vlerë pas farzeve ësh-të namazi i falur natën pas ndërprerjes së gjumit.” (Muslim, Sijam, 202-203)

“Dy reqate namaz të falura natën janë për njeriun më të dobishme se bota dhe se çdo gjë që ndodhet në të!” (Fedaili A’mal, 257)

“Nata ka një çast të tillë që muslimanit i cili e kap atë dhe i kërkon një gjë të dobishme Allahut, Allahu ia plotëson.” (Tirmidhi, Vitr, 16)

“Po qe se dikush zgjohet natën vetë, e zgjon edhe gruan dhe falin së bashku namaz, Allahu i shënon që të dy ndër njerëzit që e përmendin shumë Atë!” (Ebu Davud, Tatavvu, 18)

“Kurrsesi mos e nënvleftësoni faljen e namazit natën. Sepse ky është zakoni i njerëzve të mirë para jush. Adhurimi natën të afroh me Allahun, behet shkak për kundërshtpërblimin (keffaret) e gjynaheve, e mbron trupin prejsëmundjeve dhe largon prej gjynaheve!” (Tirmidhi)

“Allahu i faltë mëshirë atij që fal namaz natën, që e zgjon për namaz edhe të



shoqen duke i spërkatur ujë syve nëse nuk zgjohet! Allahu i faltë mëshirë edhe gruas që fal namaz natën, që e zgjon për namaz edhe të shoqin duke i spërkatur ujë syve nëse nuk zgjohet!” (Ebu Davud, Vitri, 13)

Profeti e pyeti Ebu Dherin:

“Kur kërkon të dalësh për udhë, a bën përgatitje për të?”

“Po, o i Dërguar i Allahut!” -Iu përgjigj Ebu Dheri.

Profeti e pyeti përsëri:

“Mirë, po si do të jetë udhëtimi ditën e kiametit? Dëgjomë mua! A të të them se ç’gjë do të vlejë për atë ditë?”

Ebu Dheri iu përgjigj:

“Po, o i Dërguari i Allahut që t’u bëfshin kurban nënë e babë!”

Profeti vazhdoi:

“Për ditën e ringjalljes, agjëro gjatë një dite shumë të nxehtë. Për vetminë e varrit, fal dy reqate namaz në errësirën e natës. Për



ndodhitë e mëdha të kiametit, shko një herë në haxh dhe jepi lëmoshë (sadaka) nevojtarit. Ose fol me të drejtë, ose më mirë hesht se sa të nxjerrësh nga goja një fjalë të keqe!” (Ibni Ebi Dynja, Kitabu Tehexhxxhud)

Në një hadith tjetër, duke iu drejtuar Ebu Hurejres, Profeti thotë:

“O Eba Hurejre! Po qe se do që mëshira e Allahut të jetë me ty sa je gjallë, në varr pasi të vdesësh dhe pasi të ringjallesh, ngrehu natën për hir të Allahut dhe fal namaz. O Eba Hurejre, po qe se fal namaz në qoshet e shtëpisë, ndriçimi i shtëpisë tënde bëhet si i yjesive për qiellin dhe si yll për njerëzit e botës!” (Ihjau Ulumiddin, I, 1023)

Abdullah Ibni Omeri رضي الله عنه pati parë një ëndërr dhe ia pati përcjellë atë Profetit ﷺ me anë të së motrës, Hafsa رضي الله عنها. Profeti pati thënë:

“Ç’njeri i mirë është Abdullahu, sikur të falte edhe namaz nate!..”

Pas asaj dite, Abdullah Ibni Omeri nuk e pati lënë më namazin e natës pa falur. (Buhari, Tehexhxxhud, 2)

Hadithi profetik thotë:

“Erdhi Xhebraili dhe tha kështu: “... *Nuk ka dyshim se vlera e besimtarit është te namazi i natës (tehexh-xhud)...*” (Hakim, Mustedrek, IV, 360)

Njeriu me të cilin Allahu i Lartë është i kënaqur, është njeriu që, i mbështjellë me jorgan në një shtrat të butë e të ngrohtë të një nate të ftohtë, ngrihet dhe fal namazin tehexh-xhud! Allahu mbetet shumë i kënaqur me të dhe u thotë engjëjve:

“Ç’e shtrëngon këtë robin tim të falet në këtë kohë të natës?”

Engjëjt i përgjigjen:

“Dëshira për të merituar bujarinë dhe favorin tënd dhe frika prejndëshkimit tënd!”

Atëherë, Zoti urdhëron:

“Ia kam dhënë, pra, ç’të dëshirojë prejmeje. Dhe e sigurova prej asa jqë ka frikë!” (Fedaili A’mal, 299)

Edhe në Kuran ka shumë shprehje që e



orientojnë njeriun të mos e harrojë Zotin, por ta përmendë Atë si dhe të ngrihet në namazin e natës:..

“Madhëroje Atë natën dhe pas sexh-deve.” (Kaf, 40)

“Madhëroje Atë natën dhe kur të humben yjet.” (Tur, 49)

“Ata (besimtarët e vërtetë) e kalojnë natën duke qëndruar në këmbë dhe duke rënë në sexh-de për hir të Zotit të tyre.” (Furkan, 64)

Në Kuran, duke numëruar vetitë e atyre që janë mbrojtur nga ndëshkimi hyjnor dhe kanë merituar të mirat e Tij, Zoti urdhëron:

“Ata qenë prej atyre që flinin pak netëve dhe, që, në të zbardhur, bënë pendesë.”
(Dharijat, 17-18)

Përtej këtij vlerësimi, Zoti ynë i lartë, në lidhje me vlerën dhe epërsinë e besimtarëve ndaj mohuesve, jep si shembull besimtarët që falin namaz natën dhe, duke bërë klasifikimin e të diturve me të paditurit, thotë:

“A mund të jetë si mohuesi njeriu që



falet natën duke ndenjur në këmbë e duke rënë në sexhde, që druhet prej jetës tjetër dhe që lutmëshirën e Zotit? Thuaj: “A mund të jenë të njëllojtë të diturit me të paditurit?” Mirëpo këtë e kuptojnë vetëm ata që arsyetojnë!” (Zumer, 9)

Allahu i Lartë që i karakterizon dhe vlerëson në këtë mënyrë ata që falin namaz natën, ua tërheq vëmendjen kështu atyre që, me gjithë pohimet orientuese mbi namazin natën dhe përmendjen e Allahut, vazhdojnë të mos tregojnë interesim për to:

“Bëji sexhde Atij natën dhe madhëroje Atë për një kohë të gjatë natën.”

“(Dhe dije se) Ç’është e drejta, një pjesë njerëzish (që rrinë larg sexhdes dhe madhërimit) i duan të mirat materiale që fitohen lehtë dhe e harrojnë ditën e vështirë për t’u përballuar. (Insan, 26-27)

Lidhur me adhurimin e natës, pjesa më e vlerë e natës është gjysma e dytë e saj. Profetin ﷺ e kanë pyetur:



kanë më shumë mundësi pranimi?”

Dhe ai u është përgjigjur:

“Adhurimet e bëra në pjesën e dytë të natës...” (Ebu Davud)

Ndërkaq, meqë gdhirja e natës pa gjumë nuk është aq e lehtë, është e domosdoshme të respektohen disa çështje.

Krahas dëshirës për adhurimet natën, është shumë e rëndësishme të hahet një darkë shumë e lehtë dhe të bihet herët për të fjetur. Siç thuhet edhe në hadithin profetik, “Profeti ﷺ e ndalonte fjetjen para jatsisë dhe ndenjen pa gjumë për të biseduar pas jatsisë” (Buhari, Mevakitus Salat, 23)

Përrjashtim për këtë mund të përbëjnë vetëm çështjet e shërbimit në rrugën e Allahut si dhe çështjet legale që nuk pengojnë vlerësimin e saj. Omeri ؓ thotë:

“I Dërguari i Allahut ﷺ bashkë me Ebu Bekrin bisedonin gjer në mëngjes për gjërat që u interesonin muslimanëve. Me ta rrija dhe unë.” (Tirmidhi)



Kjo hollësi është për t'u aftësuar dhe për t'u bërë i qëndrueshëm për ta mposhtur vështirësinë e ngritjes natën në namaz, për t'i zbërthyer nyjet e indiferentizmit dhe për-tacisë që na i lidh djalli në zverk. Në hadithin profetik thuhet:

“Kur ju zë gjumi, shejtani ju lidh në zverk tri nyje dhe për secilën thotë: “Paç një natë të gjatë!” Kur ngriheni natën dhe e përmendni emrin e Allahut, njëra nga nyjet zgjidhet; kur merrni abdest, zgjidhet e dyta; kurse, kur falni namaz, zgjidhet edhe e treta. Kështu, ju zgjoheni në mëngjes plot gjallëri dhe të gëzuar. Në të kundërt, ngriheni përtacë dhe me moral të prishur.” (Buhari, Tehexhxhud, 12)

Të gjitha këto që u thanë, tregojnë se vlera e namazit të natës është, pas farzeve, më e larta. Ndërkaq, që ata që falin namazin e natës, nuk duhet t'i përshkruajnë vetes ndonjë meritë duke e asgjësuar, kështu, këtë dhunti të merituar. Dhe, në lidhje me këtë çështje, duhet ta mbajnë gjithmonë parasysh hadithin që thotë:

“...Sa e sa vetë ka që falen natën, të cilët



nuk përfitojnë asgjë tjetër veç pagjumësisë!”

(Ahmed b.Hanbel, Musned, II, 373)

Namazi me xhemaat

Njëra nga momentet më të rëndësishme të çështjes së namazit është edhe falja e namazeve farze me xhemaat.

Falja e namazit me xhemaat është një sunnet muekked (i përforcuar) i nivelit të va-xhibit. Është shenjë e bashkësisë (ummetit, komunitetit). Me përjashtim të ditëve të fundit para vdekjes, Profeti kurrë nuk qe ndarë nga xhemaati.

Ngjarja e mëposhtme, e cila pohon domosdoshmërinë e xhemaatit, e vlen të shihet me kujdes:

Sahabiu i verbër, Ibnu Ummi Mektumi, për të marrë leje nga Profeti lidhur me ndjekjen e rregullt të namazit me xhemaat, i thotë:

“O i Dërguari i Allahut! Ti e di se në ç’gjendje ndodhem. Mes shtëpisë sime dhe faltores ka hurma e pemë të tjera. Dhe nuk



mund të gjej në çdo kohë dikë që të më shoqërojë!”

Profeti e pyeti:

“A e dëgjon ezanin?”

“Po, e dëgjoj!” - Iu përgjigj ai.

“Atëherë, eja të falesh me xhemaat sikur edhe të ecësh këmbë e duar!..” (I. Xhanan, Kutubi Sitte, VIII, 256)

Në një hadith tjetër pohohet se “ata që shkojnë në faltore nëpër errësirë”, ditën e ringjalljes do të rrinë nën hijen e Arshit.” (Ibni Maxhe)

Disa prej haditheve të panumërta lidhur me namazin me bashkësi, janë kështu:

“Namazi i falur me xhemaat është njëzet e shtatë gradë më i lartë se namazi i falur më vetel” (Buhari, Ezan, 30)

“...Namazi i falur me dy vetë është më i vlefshëm se namazi i falur vetë. Namazi i falur me tre vetë është më i vlefshëm se namazi i falur me dy vetë. Me sa më shumë



vetë që të falet, aq më i dashur është për Allahun.” (Ebu Davud, Nesai, Imamet, 45)

“Ai që e fal jatsinë me xhemaat, quhet se e ka kaluar gjysmën e natës me adhurim, kurse ai që e fal namazin e agimit me xhemaat, quhet se e ka kaluar tërë natën me adhurim!” (Muslim, Mesaxhid, 260)

“Kush vazhdon ta falë namazin e pesë kohëve me xhemaat, vihet në krye të atyre që e kalojnë urën e Siratit si rrufe. Vecanërisht, atë Allahu e bashkon me grupin e parë të tabiunëve (bashkëkohësve të Profetit). Ai që falet me xhemaat ditë për ditë e natë për natë, merr shpërblim sa për një mijë dëshmorë të rënë në rrugën e Allahut!”
(Xhemul Fevaïd, I, 246)

“Radhët bëjini të drejta sepse radha e drejtë është një nga përsosmëritë e namazit.” (Ebu Davud, Salat, 93)

Namazi me xhemat e rrit fuqinë e besimit te muslimanët. Ai është pasqyra e shoqërisë islame. Me anë të veprimi të vazhdueshëm



në bashkësi mbrohet shoqëria e besimit.

Në hadithin profetik porositet:

“Personi që merr abdest në shtëpi e shkon në xhami për t’u falur, është si të vishej me ihram e të shkonte në haxh.”
(Fedaili A’mal, 275)

Për çdo hap që hedh ky person duke shkuar në xhami, i falet një mëkat dhe i jepet një e mirë (thevab).

“Atij që falet me xhemaat dyzet ditë radhazi duke e arritur tekbirin e parë, i jepen dy vendime në favor: i pari, vendimi se ka shpëtuar nga xhehennemi dhe, i dyti, vendimi se ka shpëtuar nga dyfytyrësia.”
(Muslim, Tirmidhi)

Ditën e kiametit, Allahu i Lartë do të pyesë:

“Ku janë komshinjtë e mi?”

Engjëjt do ta pyesin: “Cilët janë komshinjtë e tu, o Zot?”



“Ata që shkojnë vazhdimisht në faltore (për t’u falur me xhemat).”

I Dërguari i Allahut ﷺ porositi:

“Faltorja (xhamia) është shtëpia e çdo njeriu të deotshëm. Personit, shtëpia e të cilit është faltore, Allahu ia ka garantuar rehatinë, mëshirën, kalimin e urës së Siratit, hyrjen në xhennet dhe fitimin e pëlqimit të Allahut.” (Taberani)

Vazhdimësia në bashkësi është aq e rëndësishme, saqë, në lidhje me këtë çështje, në hadithet profetike ka paralajmërime dhe qortime serioze, ka pohime për dëmet dhe humbjet që sjell ndërprerja ose mënjanimi i saj. Në njërin prej këtyre haditheve, Profeti qe shprehur kështu:

“Nëse personi që dëgjon ezanin, nuk shkon të falet me xhemaat megjithëse nuk ka ndonjë justifikim për këtë, por falet vetë aty ku ndodhet, namazi i tijështë i pavlerë!”

Shokët e patën pyetur:

“Për çfarë justifikimi bëhet fjalë këtu, o i



Dërguari i Allahut?”

Profeti u qe përgjigjur:

“Për sëmundje ose frikë nga ndonjë rrezik.” (Ebu Davud, Ibni Maxhe)

Po qe se kur hyn koha e një namazi, disa vetë kanë arsye të ndryshme që i pengojnë për të shkuar në faltore me qëllim për ta falur namazin atje me xhemaat, duhet të bashkohen, të formojnë një xhemaat dhe ta falin ashtu atë namaz. Në lidhje me këtë, pohimi profetik është kështu:

“Po qe se në një fshat ose në fushë ndodhen tre vetë që mund të formojnë një xhemaat dhe, megjithëkëtë, nuk e formojnë e nuk falen, atyre iu bie në qafë shejtani. Trajtojeni me kujdes çështjen e xhemaatit dhe merrni pjesë në të sepse ujku e ha delen që ndahet nga tufa!” (Ebu Davud, Ahmed, Nesai)

Kurse falja me xhemaat i namazeve të jatsisë dhe agimit bart një specifikë më vete:

“Kush e fal namazin e jatsisë me xhemaat, quhet se ka vazhduar të falet gjer ne



mesnate dhe kush e fal namazin e agimit me xhemaat, quhet se e ka kaluar me namaz gjithë natën!” (Muslim)

“Po ta dinin njerëzit vlerën e këndimit të ezanit dhe faljen e namazit në radhën e parë dhe për ta patur këtë mundësi, ta dinin se s’kishin zgjidhje tjetër veçse të hidhnin short, me siguri që do të hidhnin. Po ta dinin vlerën e shkuarjes herët në namaz, do të viheshin, për këtë, në garë me njëri tjetrin. Dhe po ta dinin mirësinë (thevab) të namazeve të jatsisë dhe agimit, do të shkonin për t’u falur edhe sikur t’u duhej të hiqeshin zvarrë!” (Buhari, Muslim)

Kjo do të thotë se, për ta përjetuar të fshehtën e namazit, njeriu duhet ta ketë veshin në ezan dhe zemrën në namaz. Meqë ftesa për në namaz nis me ezanin, pjesëmarrja në xhemaat nis me pjesëmarrjen në ezan. Kur këndohej ezan, shokët e Profetit çliroheshin prej të gjitha preokupacioneve materiale të kësaj bote dhe hynin menjëherë në klimën e namazit. Duart që rrihnin me çekiç, ndaleshin, gjuhët që flisnin, pushonin dhe rrugët



zgjateshin vetëm për kah faltorja. Zemrat e mbushura me ashkun e bashkimit me Zotin, e përjetonin këtë hadith profetik:

“Kur ta dëgjoni ezanin, edhe ju përsërisni fjalët e tij pas muezinit. Pastaj lutuni për mua për paqë e mëshirë, sepse kush lutet një herë për mua, Allahu i jep dhjetë herë paqë e mëshirë! Dhe këtë kërkojeni si pretekst për mua. Ky pretekst është në xhennet në atë gradë, saqë i jepet vetëm njërit prej robve të Allahut. Ja, pra, unë, ky rob kërkoj të jem. Kush lut pretekst për mua, e meriton ndërmjetësimin (shefaat) tim!” (Muslim, Salat, 11)

Lutja e ezanit që duhet kënduar si përgjigje imediate e këtij hadithi profetik, është kështu:

Kurse shkuarja dhe kthimi nga faltorja në mënyrë të pavetëdijshme dhe pa përfituar nga synimi i lartë e i thellë i këtij hadithi profetik, nuk i jep mundësi njeriut të arrijë qëllimin e tij të vërtetë. Kështu, nuk duhet harruar e vërteta e shprehur me hadithin si më poshtë:



“Me ç’qëllim të vijë personi në faltore, atë arrin, përfitimi i tij ai do të jetë!” (Ebu Davud)

Nga ana tjetër, xhemati, bashkësia, e mëson pjesëtarin e saj, njeriun, ta vërë nën disiplinë jetën e cila, përsa i përket preokupimit, është e mbushur plot skena të trazuara e të ndërthurura si dhe, duke i ofruar njeriut një rregullsi dhe sistematikë të caktuar, e bën të aftë të mendojë e të sillet në mënyrë të ekuilibruar. Lidhur me këtë çështje, siç dihet, ekziston hadithi i mëposhtëm, i cili, duke i edukuar seriozisht edhe njerëzit më të zakonshëm e të parregullt, i çon ata në një adhurim të denjë për audiencën hyjnore. Ndryshe, në namazin me xhemaat do të ishte e pamundur të sigurohej rregulli dhe drejtpeshimi:

“Kush e ngre kokën para imamit, a nuk ka frikë se Allahu do t’ia shndërrojë kokën në kokë gomari?”¹ (Buhari, Muslim)

1. Sipas dijetarëve islamë, çështja e mundësisë së shndërrimit në kokë gomari apo, sipas një rrëfimi (rivajet) tjetër, në kokë qeni i kokës së personit që, në namazin me xhemaat, e ngre kokën para imamit, mundet të pohojë një shndërrim ndjesor, domethënë, moralo-shpirtëror, pra, është një aluzion për kokëtrashësi dhe patejpmësi. Edhe shndërrimi formal, konkret, është i mundur, por realizimi i së mund-



Fjala e fundit që mund të thuhet mbi namazin me xhemat, është që zemra e besimtarëve duhet të jetë pothuaj e varur në faltore. Sepse, në ditën e kiametit, në atë mjedis të tmerrshëm ku nuk ndodhet asnjë hije, njëri prej shtatë klasa ve njerëzore që do të trajtohet nën një hije hyjnore, do të jetë “klasa e besimtarëve me zemrën varur në faltore”.

Namazi si strehim i vetëm

Namazi që është më e veçanta prej adhurimeve, është, njëkohësisht, edhe më e veçanta prej formave të strehimit të Zoti. Prandaj, sapo të përballemi me ndonjë vështirësi, shqetësim, fatkeqësi, vuajtje, hidhërim apo dëshpërim, duhet të kapemi menjëherë pas namazit! Kjo është një traditë e zbatuar shpesh në jetën e Profetit ﷺ.

Hudhejfe عليه السلام thotë:

“Kur i Dërguari i Allahut përballej me një punë të vështirë, menjëherë ia kushtonte veten namazit!” (Ahmed, Ebu Davud)



Ebu Derda ﴿﴾ thotë:

“Kur niste furtuna, i Dërguari i Allahut hynte menjëherë në faltore dhe nuk dilte prej atje gjersa të ndërpritej. Po kështu, edhe kur zihej dielli ose hëna, ai niste menjëherë të falej.”

Këtu është e nevojshme të bëhet një vlerësim i drejtë i eklipsit të hënës dhe diellit. Atë ditë që Profetit i vdiq djali, Ibrahim, ndodhi eklipsi i diellit. Disa prej shokëve të Profetit thanë:

“Dielli u zu sepse vdiq djali i të Dërguarit të Allahut!”

Profeti, duke mos e miratuar këtë opinion të shokëve, tha:

“Si dielli, ashtu dhe hëna nuk mund të zihen për vdekjen apo lindjen e një njeriu!”
(Muslim, Kusuf, 29)

Nga ana tjetër, me rastin e një eklipsi të diellit, Es-maja ﴿﴾, bija e Ebu Bekrit ﴿﴾, e pyeti Aishenë ﴿﴾ :

“A është kjo një shenjë ndëshkimi apo kiameti?”



“Po!” - Iu përgjigj Aisheja ﴿﴾.

Amr bin As ﴿﴾ rrëfen kështu:

“Ishte zënë dielli. I Dërguari i Allahut ﴿﴾ u ngrit në këmbë dhe qëndroi në namaz. Aq gjatë qëndroi në këmbë (kijam), saqë kujtuam se nuk do të përkulet në ruku. Pastaj, pasi u përkul, qëndroi aq gjatë përkulur, saqë kujtuam se nuk do ta ngrejë kokën. Pastaj e ngriti kokën dhe ra në sexhde ku përsëri qëndroi aq gjatë, saqë kujtuam se nuk do të ngrihej më nga sexhdja. Më në fund, e ngriti kokën nga sexhdja dhe qëndroi ndenjur aq gjatë, saqë kujtuam se nuk do të bjerë përsëri në sexhde. Edhe kur ra përsëri në sexhde, qëndroi aq gjatë, saqë kujtuam se nuk do ta ngrejë kokën më. Më në fund e ngriti kokën, u ngrit në këmbë dhe po kështu veproi edhe në reqatin e dytë. Në sexhde qante.

Pastaj Profeti u lut kështu:

“Zoti im, a nuk më premtove se nuk ke për t’i ndëshkuar këta përsa kohë do të jem mes tyre? A nuk më premtove se nuk do t’i ndëshkosh këta përsa kohë do të të shfaqin pendesë?..”



Kur i Dërguari i Allahut e mbaroi nama-zin, dielli kishte dalë nga zënia dhe kishte nisur të shpërndajë rreze gjithandej!” (Nesai, Ebu Davud)

Këto deklarata profetike tregojnë se zënia e diellit nuk është një dukuri natyrore e zakonshme. Kjo dukuri na kujton madhështinë dhe tmerrin hyjnor. Në të njëjtën kohë, eklipsi është një paralajmërim hyjnor dhe një shenjë kiameti. Sepse errësimi i mjedisit menjëherë mu në mes të ditës është kah tregon se si i nënshtrohen dielli dhe hëna Allahut, Zotit të botëve, duke na e treguar qoftë edhe për një çast, se ç’do të ndodhë në ditën e kiametit gjersa njerëzit të marrin mësim nga kjo dhe të jenë vazhdimisht syçelë, të mos gënjehen nga kjo botë e vdekshme dhe ta dinë se çdo gjë është kalimtare dhe, më në fund, që të mos i lënë përgatitjet për botën tjetër. Sepse dielli i zënë mund të mos hapet edhe një herë tjetër më!

Këto lloj paralajmërimesh të Zotit mund t’i shohim edhe në fusha të tjera. Për she-mbull, të këtij lloji janë edhe vijat e thyerjeve



tektonike. Allahu i Lartë mund t'ua marrë jetën grupimeve të mëdha njerëzore edhe pa e vënë në lëvizje thyerjen tektonike. Mirëpo, duke i nxjerrë në pah thyerjet tektonike, për rrjedhojë, duke u vënë njerëzve para sysh një rrezik evident, i favorizon ata me mundësinë që u jep për të qenë vazhdimisht syçelë. Sigurisht që nuk janë vetëm këto paralajmërimet hyjnore. Përmbytjet, furtunat, sëmundjet e pashërueshme, etj. janë, gjithashtu, paralajmërimi hyjnore. Ashtu siç thotë edhe poeti:

Njerëzisë i ka ardhur vdekja,

Ti më thua se po i dhëmb koka!..

Por duhet ta përsërisim se po të mos ishin këto shkaqe dhe pretekste, njerëzimi, i painformuar e i pa paralajmëruar për asgjë, do të binte në befasi në kthetrat e vdekjes e do të shkatërrohej. Prandaj, Allahu i Lartë që është mëshirues, me anë të shenjave e paralajmërimeve të ndryshme për ngjarjet që do të ndodhin pa tjetër në të ardhmen, i jep mundësi njeriut t'i njohë të vërtetat e larta dhe absolute e të përgatitet para se të jetë vonë.



“Një ditë, mu në mes të ditës, pati rënë një errësirë e tmerrshme. Shkova me vrap te Enesi dhe e pyeta:

“A pati ndodhur një gjë e tillë edhe në kohë të të Dërguarit të Allahut?”

Ai më tha:

“Na ruajttë Zoti! Në kohën e të Dërguarit të Allahut, edhe sikur era të frynte pak si e shpejtë, vraponim për në faltore duke menduar se po ndodh kiameti!”

Namazi është një mburojë si para shumë fatkeqësive në këtë botë, ashtu dhe para zjarrit të xhehennemit në jetën tjetër (ahiret). Allahu i Lartë urdhëron:

“O ju që keni besuar! Kërkoni ndihmë me durim dhe namaz!..” (Bekara, 153)

Eshtë e njohur familja e Faraonit që kishte në dorë sundimin e Egjiptit. Këta janë njerëz që kanë kaluar në histori më shumë me padrejtësi, dhunë dhe mendjemadhësi. E njëjta familje sundonte në Egjipt edhe në kohën e Ibrahimit. Faraoni, si sundues që ishte, kapte



çdo femër të huaje të bukur që hynte në qytet; po të ishte e martuar, ia vriste burrin, kurse, po të kishte vëlla, e kërkonte prej të vëllait.

Kur Ibrahimî ﴿ٱلْحَبَشِيُّ﴾, pas shkatërrimit të Nemrudit, kaloi nga kufiri i Egjiptit së bashku me Saren, lajmi i shkoi Faraonit. Njerëzit e dërguar prej Faraonit, e pyetën Ibrahimin ﴿ٱلْحَبَشِيُّ﴾ se kush ishte gruaja që kishte me vete. Duke përdorur një “dredhi legjitime”, Ibrahimî tha “motra” duke pasur parasysh “motër në fe”. Atëherë, njerëzit e Faraonit nuk i bënë gjë Ibrahimit, kurse Saren e morën dhe e çuan në pallat te Faraoni. Siç thotë Buhariu, “sapo hyri në pallat, Sareja mori abdest dhe fali dy reqate namaz, u strehua te Zoti dhe Ai e mori nën mbrojtje.”

Si përfundim, Faraonit që kërkoj t’i afrohej Sares, iu pre fryma. Faraoni u paralizua. Sepse Saren po e mbronte Allahu i Lartë nga e keqja e Faraonit.

I trembur dhe i frikësuar në kulm, Faraoni e la të lirë Saren. Për më tepër, i dhuroi shërbëtoreshen e vet, Haxherin. Parësia e pallatit po vështronte me habi ngjarjet dhe veprimet e Faraonit. Ky u tha:



“Kjo femër është një xhind. Edhe pak të kishte qëndruar pranë meje, do të kisha marrë fund. Për t’u mbrojtur nga dëmi që mund të më shkaktojë, i dhurova Haxherin.”

Ja, pra, rezultati moralo-shpirtëror në këtë botë i namazit dy reqatesh të falur sinqerisht për hir të Zotit!

Prandaj, kur përballej me ndonjë vështirësi apo ngushticë, Profeti menjëherë i urdhëronte njerëzit e shtëpisë të falnin namaz dhe këndonte këtë ajet:

“O i Dërguar! Urdhëroji për namaz familjen tënde dhe ummetin tënd dhe vazhdo me namaz edhe ti! Ne s’kërkojmë gjë prej teje, por të furnizojmë ty. Fundi i mirë është për ata që ruhen nga të këqijat!” (Taha, 132)

Kështu, Profeti i cili i urdhëronte familjen dhe ummetin e vet për të falur namaz në kohë frike, vështirësie dhe fatkeqësie, thoshte se edhe profetët e shkuar, kur përballeshin me vështirësi, te namazi mbështeteshin:

“Edhe profetët e kaluar i drejtoheshin namazit në çaste fatkeqësie.” (Fedaili A’mal, 249)



Disa herë thoshte kështu:

“Allahu e ndihmon këtë ummet në sajë të lutjeve, namazeve dhe singeritetit të të dobtëve!” (Nesai, Xhihad, 43)

Allame Sharaniu thotë:

“Duhet ditur mirë se, ashtu siç zbresin fatkeqësitë mbi vendet e atyre që s’falin namaz, ashtu dhe largohen nga vendet e atyre që falin namaz. Askush të mos thotë: “Unë për vete falem, ç’më duhet se ç’bën tjetri?”² Sepse, kur vjen fatkeqësia, vjen për të gjithë. Kur e kanë pyetur Profetin, lidhur me këtë çështje, nëse mund të shkatërrohen vende ku jetojnë edhe njerëz të mirë, është përgjigjur:

“Po, kur të këqijat të shtohen e t’i kalojnë të mirat..” (Muslim, Fiten, 1)

Prandaj, çdo besimtar ka përgjegjësi ta ndalojë të keqen dhe të nxisë të mirën me aq sa fuqi që ka.

2. Në Fatiha thuhet: “Vetëm Ty të adhurojmë dhe ndihmën vetëm prej Teje e kërkojmë!” Kështu, adhurimi kërkohet të bëhet i përbashkët, po ashtu edhe kërkesa e ndihmës. Prandaj është i nevojshëm shoqërizimi dhe ecja si një trup i vetëm në rrugën e drejtë (siratul mustakim). Për rrjedhojë, duhet difuzioni i zemrave dhe bashkimi i tyre si një e tërë.

Nga ana tjetër, e vetmja rrugë për t'u mbrojtur nga indiferentizmi ndaj paralajmërimeve hyjnore, për ta lehtësuar barrën e përgjegjësisë dhe për të merituar mbrojtjen hyjnore, është mbështetja te namazi. Me fjalë të tjera, pastrimi nga mëkatet është i mundur me pendesë dhe namaz. Një personi mëkatar që ka shkuar në kuvendin e Profetit me një qëndrim thellësisht pendestar dhe ka falur namaz së bashku me të, ai i ka thënë:

“Allahu t'i fali gjynahet!” (Muslim, Ebu Davud, Buhari)

Namazi i falur drejt e saktë

Në Kuran, urdhri i Zotit lidhur me namazin nuk është i formës, “falni namaz!”, por kështu:

“Faleni namazin drejt e saktël

Namasi i falur drejt e saktë është një adhurim me shumë vlerë që e shpëton besimtarin nga vorbulla e prirjeve egoistike, që e bën të përjetojë ekstazë (dalldí). Në ajetin Kuranor urdhërohet:



“...dhe fal namazin. Me të vërtetë, namazi të largon nga gjërat e turpshme e të shëmtuara...” (Ankebut, 45)

Namazi e pengon njeriun nga të këqijat edhe para, edhe gjatë, edhe pas faljes së tij. Po qe se te një njeri që fal namaz nuk vihet re një pengim dhe mbrojtje e tillë, ai person nuk e fal namazin rregullisht. Për namazin e njerëzve të tillë, Profeti ﷺ thotë:

“Kush fal namaz dhe namazi nuk e largon atë prej të këqiave të fshehta e të hapura, nuk bën tjetër veçse ia shton largësinë prej Allahut!” (Xhamul Fevaid, 339)

Prandaj, çështja më e rëndësishme që duhet patur kujdes në namaz është, pa asnjë dyshim, përshpirtshmëria.

Namazet e falura me indiferentizëm

Namazi i falur me një zemër larg etikës dhe rregullsisë dhe ku është përzierë ndërhyrja e djallit, është pothuaj si një paçavure mëkati që i përplasit fytyrës së rob-it. Në Kuran urdhërohet:



“Sa keq për ata që janë të pakujdes-shëm ndaj namazit të tyre. Ata veprojnë sa për sy e faqe dhe pengojnë të mirën.”

(Maun, 4-7)

Komentuesit (mufessir) e Kuranit e kanë përshkruar indiferentizmin në namaz në tri forma:

1. Mosnjohje dhe mosshfrytëzim i kohës së një namazi dhe lënie e tij për ta falur kaza.
2. Falja e namazit pa interes, duke bërë veprime me trup e duke e pasur shpirtin jashtë tij.
3. Shkujdesja ndaj rregullave ligjore të namazit.

Poeti Mevlana thotë:

“Pyeta mendjen time: “Ç’është besimi?”
Mendja u përkul te veshi i zemrës dhe i pëshpëriti: “Besimi është edukatë!”

Edukata më e madhe është respekti dhe nderimi i thellë ndaj Allahut, shenjtërimi i Tij, gjë që bëhet në formën më të bukur në adhurime, veçanërisht në namaz.



Indiferentizmi në cilindo prejelementëve të përmbajtjes, etikës dhe rregullit të namazit, është diçka që shejtani ka shkëputur prej njeriut. Prirja e atij që fal namaz për indiferentizëm i jep rast shejtanit për t'i rënë në qafë. Dhe, naty. risht, namazi i dobësuar prej shejtanit nuk është i pranue. shëm.

Disa tregohen mbrojtës të zjarhtë të islamit por, duke mos e konceptuar denjësisht rëndësinë e namazit, tregohen në të të plogësht e indiferentë. Ata sillen pa interes duke mos u dhënë rëndësi urdhrave dhe porosive Kur'anore dhe profetike. Krahas nënvleftësimit të përshtpirtshmërisë së namazit, lënë mangësi në respektimin e pjesëve të tij. Namazi i tyre është pothuaj si një punë angari. Zoti na mbrojtë të gjithëve prejnjë indiferentizmi të tillë!

Ata që bien në gropën e këtij indiferentizmi, u përngajnë njerëzve të falimentuar pasi e kanë shpërdoruar pasurinë sa një mal që kanë pasur në dorë. Ç'mbetet pas kësaj në dorë, është vetëm lodhje. Në hadithin profetik thuhet:



“Sa vetë ka që falin namaz, përfitimi i të cilëve nga namazi s’është gjë tjetër veçse lodhje e mundim!” (Nesai)

“Allahu nuk u jep vlerë të mirave të tjera të njeriut i cili, megjithëse e çon kot namazin, kërkon të takohet me Allahun!”
(Taberani)

Në mënyrë të veçantë, duke e cilësuar si “hajdutëri” faljen e namazit duke lënë mangut elementët përbërës si dhe etikën e tij, Profeti ﷺ thotë:

“Hajduti më i keq ndër njerëzit është ai që vjedh nga namazi!” (Ahmed dhe Hakim)

Meqë kjo vjedhje është punë e shejtanit, në dorë të njeriut, siç u tha edhe në hadithet profetike më parë, s’mbetet gjë veç lodhjes. Për rrjedhojë, ata që vjedhin nga namazi, duhet ta kujtojnë qortimin e rëndë të Allahut:

“Sa keq për ata që s’tregohen seriozë ndaj namazit të tyre!” (Maun, 4-5)

Ky ajet tregon se, ndërsa ata që përtojnë, nuk afrohen te namazi, ata që nuk munden ta



kapërcejnë pengesën ego, mbeten në anën formale të namazit pa përfitur prej frymës së tij shpirtërore. E thënë ndryshe, kush nuk fal namaz siç përshkruhet, nuk di gjë se ndodhet në audiencën hyjnore dhe gjatë namazit e preokupon mendjen me çështje të interesave materiale të kësaj bote, ai kurrë s'quhet se fal namaz. Namazi i falur prej tij mbetet këtu.

Namazi që e përsos besimin në zemër, në njerëz të tillë indiferentë përfundon me izolim. Si një nyjë në qafë ose si një pasqyrë që ua tradhton dyfytërsinë, bëhet lajmëtar i ndëshkimit të dhimbshëm:

“Hipokritët përpiqen ta gënjejnë Allahun. Kurse Ai ua kthen atyre vetë atë përpjekje për gënjim. Kur ngrihen për në namaz, ata ngrihen duke përtuar, kërkojnë të duken para njerëzve dhe Allahun pak e përmendin!” (Nisa, 142)

Ata që rrinë larg namazit

Njerëzit e zemrës, për t'i qortuar e paralajmëruar ata që rrinë larg namazit, thonë kështu:



“Ata që, të rënë në indiferentizëm prej sasisë së madhe të mallit e pasurisë, nuk mundën të afrohen te namazi, pas ringjalljes do të bashkohen me Karunin. Ata që s’afrohen dot prej komoditetit dhe pushtetit, do të bashkohen me Faraonin. Ata që s’afrohen dot prej nëpunësisë së lartë shtetërore, do të bashkohen me Hamanin. Ata që s’afrohen dot prej tregtisë dhe fitimit të saj, do të bashkohen me Ubej bin Halefin, dushmanin e Profetit...”

Personat larg namazit jetojnë në këtë botë një jetë pa duk. Në fytyrat e tyre, nga drita e bukurisë hyjnore s’mбетet gjë. Asnjë të mire të tyre nuk u jepet shpërblim. Lutjet e tyre nuk pranohen. Ata mbeten pa dashurinë e njerëzve të mirë. Siç thotë hadithi profetik, “Siç të rroni, ashtu do të vdisni”, gjë e vërtetuar, kjo, gjatë gjithë historisë, agonia e tyre është e rrezikshme dhe ata japin shpirt me dhimbje. Varri i shtrëngon dhe u bëhet një gropë si gropat e xhehennemit. Në ditën e kiametit e shohin se Zoti i ka ndëshkuar. Llogaridhënia u kalon tepër e vështirë dhe, më në fund, hidhen në xhehennem.



Siç përcillet te Buhariu, pas namazit të agimit, Profeti i pyeste shokët se mos kishin parë ndonjë ëndërr. Ata që kishin parë, rrëfenin, kurse ai ua shpjegonte. Një ditë, siç e kishte zakon, i pyeti prapë. Dhe, pastaj, tha:

“Unë pashë një ëndërr. Erdhën dy vetë, më morën me vete e shkuan!”

Pastaj vazhdoi ta tregojë ëndrrën gjerrë e gjatë. I tregoi një e nga një xhennetin, xhehennemin dhe ndëshkimet që jepeshin në xhehennem. Njëri po ndëshkohej duke iu shtypur koka me një gur. Guri e godiste aq fort saqë kthehej mbrapsht e binte. Guri ngrihej, e godiste përsëri dhe përsëri kthehej mbrapsht e binte e kështu në vazhdim.

Profeti i pyeti shoqëruesit:

“Kush është ky?”

Shoqëruesit iu përgjigjën:

“Ky njeri, megjithëse e mësoi ta këndonte Kuranin, binte të flinte pa kënduar Kuran e pa falur namaz.”



Lufta e djallit me njeriun më tepër mbi çështjen e namazit se sa të adhurimeve të tjera, ka për qëllim që ta sjellë njeriun në gjendjen për të cilën hadithi profetik thotë, “Ai që s’ka namaz, s’ka fe”, për rrjedhojë, ta shmangë atë, ashtu si veten, nga mëshira hyjnore.

Prandaj, besimtarët tejpamës e mbrojnë veten nga kurthet e djallit në këtë rrugë, nxi-tohen t’i falin kaza namazet e mbetura pa falur për ndonjë shkak dhe nuk lënë pa bërë asnjë përpjekje për këtë.

Po qe se nuk i kushtohet kujdes pohimit të hadithit profetik, “*Kush e ka harruar një namaz pa falur, ta falë menjëherë atë sapo ta kujtojë; kjo s’ka ndonjë kundërpagesë tjetër*” (Muslim, Mesaxhid, 314) borxhet e namazit do të grumbullohen si mal dhe, si rezultat, njeriu në jetën tjetër do të pësojë disfatë!

Namazi është një dallim

Duke i deklaruar një muslimani si më poshtë, i Dërguari i Allahut ﷺ së pari ia mësonte atij namazin, pastaji tregonte se nama-



zi, si shtylla e fesë, përbënte një dallim mes muslimanit dhe mohuesit:

“Namazi është shenja e islamit. Musliman është ai që ia jep zemrën namazit, që e kryen atë duke respektuar kohët dhe pjesët përbërëse të tij.” (Fedaili A’mal, 255-256)

Edhe shokët e Profetit nuk quanin mohim (kufr) braktisjen e ndonjë veprimi tjetër veç namazit. Kur vinte koha e namazit, Ebu Bekr Besniku ﷺ u thoshte atyre që kishte përreth:

“O njerëz, ngrihuni! Zjarrin që ndezët, shuajeni me namaz!”

Namazi nuk është vetëm shenjë dalluese mes muslimanit dhe mohuesit (kafir), por edhe shenjë dalluese e nivelit mes një muslimani dhe një tjetri. Lidhur me këtë çështje, Ebu Hurejre përcjell këtë rrëfim (rivajet):

“Dy vetë nga një gjak i fisit Udaa erdhën te Profeti dhe u bënë muslimanë. Më pas, njëri prej tyre ra dëshmor në një luftë. Tjetri vdiq një vit më vonë nga vdekja e natyrshme.



Unë pashë në ëndërr se ai që vdiq nga vdekja e natyrshme, hyri në xhennet më parë se ai që ra dëshmor. Unë mendova me vete me habi:

“Niveli i dëshmorit është shumë më i lartë. Ai duhet të hynte më parë në xhennet!..”

Kur këtë ia tregova të Dërguarit të Allahut, tha:

“A nuk e sheh se sa të shumta janë mirësitë (thevab) të atij që vdiq një vit më vonë? Pas atij që ra dëshmor, ky agjëroi tërë ramazanin. Pastaj, një vit të tërë, fali gjash-të mijë e ca reqate namaz duke bërë më shumë adhurime se ai!” (Ahmed, Ibni Maxhe)

Ngjashëm me këtë, në një hadith tjetër, i Dërguari i Allahut u tha shokëve:

“Personi i vdekur një vit më pas a nuk bëri më shumë adhurim?”

“Pa dyshim, ashtu!” - thanë shokët.

Dhe Profeti tha:

“Atëherë, mes dy vetëve ka dallim sa mes tokës e qiellit!”



Kjo e veçanta e madhe e namazit është deklaruar edhe në këto hadithe profetike:

“Allahu i Lartë asgjë s’e ka bërë më të shquar se besimin dhe namazin. Po të kishte bërë ndonjë gjë tjetër më të shquar, do t’ua kishte kërkuar edhe engjëjve. Mirëpo engjëjt janë natë e ditë një pjesë në ruku e, një pjesë, në sexhde.”

“Namazi është xihadi më me vlerë.”

“Kur persori qëndron në namaz, Allahu i shfaqet atij dhe, kur e mbaron namazin, edhe shfaqja e Allahut për të merr fund.”
(Fedaili A’mal, 256)

“Kur nga qielli zbret ndonjë fatkeqësi, ajo largohet prej atyre që ndodhen në faltore.” (Fedaili A’mal, 256)

“Çelësi i xhennetit është namazi.” (Tirmidhi, Taharet, 3)

“Namazi është kurbani i çdo njeriu të bindur.” (Kuzai, Musned, I, 181)

“Për atë që i kalon pa falur edhe një namaz i vetëm, madje, është sikur t’i jenë marrë



nga dora tërë malli e fëmija!” (Nesai, Ahmed)

Si rrjedhojë e kësaj epërsie dhe rëndësie të namazit, edukimi i tij te njerëzit nis qysh në moshat e vogla. Qëndrimi serioz dhe korrekt ndaj kësaj çështjeje, ruajtja prej indiferentizmit dhe nënvleftësimit të saj shprehen kështu me gjuhën e bekuar të Profetit ﷺ:

“Urdhërojeni fëmijët për namaz në shtatë vjeç. Në dhjetë vjeç, nëse s’falen, përdorni lehtësisht dhunën. Dhe shtrojuni të flenë veç.”
(Ebu Davud)

Përmbledhje

Është tepër domethënëse që për zemrën, bajramet (festat), të cilat, si një favor, i mbrujnë vuajtjen, mundimin dhe dhimbjen me gëzim, nisin me namaz! Prandaj është me vend të mendohet se për njerëzit e namazit në këtë botë, jeta e amshuar (ahiret) do të favorizohet si një bajram. Sepse namazi ka një përmbajtje të tillë që e çon në përsosje njeriun në të gjitha aspektet dhe që e përgatit atë për shpërblimin hyjnor. Shkurt mund të themi:



Nga pikëpamja materiale, namazi, me anë të lëvizjeve fizike të brendshme e të jashtme dhe me anë të sundimit të kohës, përbën përsëritjet praktikuese të jetesës në mënyrë të rregullt.

Si vlerë morale-shpirtërore, namazi është plot begati e fryte, si dalje para Zotit, si meditim,

si qetësim në kohë frike e kënaqësi në kohë hareje, si mbështetje për botën shpirtërore, si gëzim zemre, si mbrojtës besimi, si shtues i afërsisë dhe miqësisë hyjnore.

Nga pikëpamja e bukurive shoqërore, namazi është sinqeriteti i përfutur nga dalja në audiencën hyjnore, është çuarja e botës ndjesore në një klimë shpirtërore pranverore.

Këtu duhet pohuar se, në kuptimin njerëzor, asnjë justifikim për të mos falur namaz nuk është efektiv. Meshkujt falin namaz edhe në luftë duke zbatuar radhën. Edhe për femrat nuk ka justifikim tjetër veç gjendjeve të tyre të posaçme të justifikuara.



ndaj porosisë së Profetit, “Kujdesuni për namazin, për namazin!..” të theksuar prej tij në çastet kur sëmundja i ishte rënduar aq sa e kishte vështirë edhe për t’i shqiptuar fjalët dhe kur po jetonte frymën e fundit!

Ja, pra, zemrat që ia vënë veshin kësaj porosie dhe e kuptojnë të vërtetën e namazit, e shndërrojnë atë në dritë të syve. Kur qëndrojnë në namaz, çlirohen nga kjo botë e vdekshme për u mbështjellë me frymën shpirtërore, arrijnë të përjetojnë shfaqje të afrisë hyjnore.

Falësi i vërtetë i namazit është ai që bart të gjitha veçoritë që përmban namazi. Karakteristikat e mëposhtme të sures “Mearixh” kanë vlerën e një pjese të veçorive në fjalë:

1. Ata janë gjithmonë në namaz.
2. Heqin një pjesë nga pasuria për nevojtarët që, për shkak të varfërisë e cila u dallohet nga jashtë dhe virtytit, kanë turp të kërkojnë.
3. E vërtetojnë ditën e gjykimit.



4. Kanë frikë nga Zoti i tyre.
5. E mbrojnë nderin e vet.
6. Kujdesen për amanetin dhe fjalën e dhënë.
7. Bëjnë dëshmi të drejtë.
8. Kujdesen për namazin dhe e mbrojnë atë.

“Ja, pra, këta priten me respekt në xhennet.” (Mearixh, 23-25)

O Zot! Na i bëj namazet si ato që falen me kuptimin dhe urtësinë e tyre të vërtetë, që, me cilësinë e një miraxhi, nderohen me afrinë dhe shikimin me Ty! Namazet na u bëfshin drita e syve dhe gëzimi i zemrave tona në të dy botët!

Amin!..



ABDESTI, GUSLI, TEJEMMUMI, NAMAZI

sipas legjislacionit fetar islam (fikh)

ABDESTI

Farzet (detyrimet) e abdestit

1. Larja e fytyrës.
2. Larja e duarve dhe e parakrahëve gjer në bërryla.
3. Fërkimi i një të katërtës së kokës.
4. Larja e këmbëve së bashku me thembrat.

Sunnetet (traditat) e abdestit

1. Vënia e qëllimit (nijet) për të marrë abdest.



2. Fillimi i abdestit me Eudhu-Besmele.
3. Para fillimit të abdestit, larja e duarve gjer në nyjet.
4. Pastrimi i dhëmbëve me misvak ose furçë dherabe ose me gishta.
5. Larja e organeve të abdestit njëri pas tjetrit pa ndërprerje.
6. Fërkimi i organeve që lahen, gjatë larjes.
7. Marrja ujë në gojë tri herë.
8. Bërja e gargarës kur nuk mbahet agjërim.
9. Tërheqja ujë hundëve tri herë dhe fryrja e tyre me dorën e majtë.
10. Çdo organ që lahet, të lahet tri herë.
11. Larja e organeve çift duke nisur me organin e djathtë.
12. Larja e duarve dhe e këmbëve të fillojë nga majat e gishtave.
13. Fërkimi i mjekrës (për ata që kanë mjekër) duke futur gishtat nëpër të.
14. Lëvizja e unazës së gishtit për të siguruar kalimin e ujit nëpër të.



15. Fërkimi i veshëve.
16. Fërkimi i zverkut.
17. Fërkimi i gjithë kokës.
18. Fërkimi i hapësirave mes gishtave.

GUSLI (Larja trupore e plotë)

Farzet

1. Marrja ujë në gojë dhe shpëlarja e saj e thellë gjer në grykë.
2. Tërheqja ujë hundëve dhe pastrimi i tyre.
3. Larja e plotë e trupit.

Sunnetet

1. Vënia e qëllimit për të bërë gusl.
2. Fillimi me Besmele.
3. Po qe se në ndonjë pjesë të trupit ka papastërti, pastrimi në fillim i asaj pjese të trupit.
4. Larja e organeve të jashtëqitjes dhe gjennitale.
5. Marrja e abdestit para guslit.



6. Derdhja e ujit tri herë mbi trup duke bërë që të laget i gjithë trupi.
7. Derdhja e ujit mbi trup të fillojë nga koka, pastaj të derdhet mbi supin e djathtë, pastaj në supin e majtë; qysh në derdhjen e parë, fërkimi i trupit dhe sigurimi i kalimit të ujit në të gjitha anët e trupit.
8. Po qe se në vendin e këmbëve mbliidhet ujë, gjatë marrjes së abdestit lënia e larjes së këmbëve për në fund.

TEJEMMUMI (Pastrimi me dhé)

Farzet

1. Vënia e qëllimit për tejemmum.
2. Prekja me fërkim të lehtë me pëllëmbë dy herë e dheut ose e një sendi prej dheu dhe, herën e parë, fërkimi i fytyrës, herën e dytë, fërkimi i parakrahëve.

Sunnetet

1. Fillimi i tejemmumit me Eudhu-Bes-mele.
2. Respektimi i radhës së veprimeve.



3. Kryerja e veprimeve pa ndërprerje.
4. Kur pëllëmbët prekin tokën, në fillim të fërkohen para, pastaj duke u tërhequr pas.
5. Gishtat të mbahen shtrirë dhe hapur.
6. Pasi të ngrihen duart nga prekja në dhé, të shkunden nëse kanë pluhur duke i përplasur me njëra-tjetrën.

NAMAZI

Farzet e namazit janë dymbëdhjetë. Një pjesë e këtyre kryen para namazit si përgatitje për të. Këto quhen “kushtet e namazit”. Një pjesë tjetër kryhen gjatë namazit dhe quhen “shtyllat e namazit”.

Kushtet e namazit

1. Pastrimi nga aksidentet (hadeth). Është pastrimi nga papastërtitë që nuk shihen me sy. Në këtë lloj pastrimi futen abdesti, gusli dhe tejemmumi në pamundësi të tyre.
2. Pastrimi nga papastërtitë (nexhaset). Esh-të pastrimi nga papastërtitë që shihen me



sy. Këto papastërti mund të ndodhen në trupin dhe rrobat e njeriut që do të falë namaz dhe në vendin ku do të falet namaz.

3. Mbulimi i pjesëve intime të trupit (setrul avret). Është mbulimi i pjesëve intime që duhen mbuluar. Te meshkujt, pjesa intime që duhet mbuluar, është pjesa mes kupës së gjurit dhe kërthizës duke i përfshirë edhe këto në mbulim. Te femrat, gjithë trupi me përjashtim të fytyrës, duarve (gjer në nyje) dhe këmbëve (gjer në nyje). Po që se gjate namazit zbulohet për një interval kohe sa një shtyllë namazi një e katërta e një organi që duhet mbajtur i mbuluar, namazi prishet.
4. Drejtimi kah kiblja (istikbali kible). Është kthimi me gjoks i personit që ka për të falur namaz, kah drejtimi i vendndodhjes së Qabes. Namazi i personit që e shmang gjoksin nga drejtimi i Qabes, prishet.
5. Koha. Për çdo namaz farz (detyrim) si dhe vaxhib (domosdoshmëri) ka një kohë të caktuar. Falja e namazit brenda kohës së vet është e detyruar (farz). Namazi nuk



mund të falet pa i ardhur koha e caktuar. Lënia e faljes së një namazi për një kohë më pas pa justifikim është gjynah (mëkat).

6. Qëllimi (nijet). Është kujtimi me mend i namazit që për t'u falur. Imami duhet të formulojë qëllimin për ta drejtuar namazin (imamet), kurse xhemaati duhet të formulojë qëllimin për t'u lidhur pas imamit.

Shtyllat e namazit

1. Tekbiri i fillimit (iftitah). Është tekbiri me te cilin fillon namazi. Pas formulimit të qëllimit, duke thënë "Allahu Ekber", ngrihen duart lart.
2. Qëndrimi në këmbë (kijam). Është pjesa e namazit duke qëndruar në këmbë. Ata që s'kanë mundësi të qëndrojnë në këmbë, e falin namazin ashtu siç kanë mundësi.
3. Këndimi (kiraat). Është këndimi i pjesëve nga Kur'ani. Këndimi është fragment i qëndrimit në këmbë dhe përbëhet prej më e pakta tre suresh të shkurtra të Kur'anit.



4. Qëndrimi përkulur (ruku). Pas këndimit, kalohet në qëndrimin përkulur në mënyrë që pëllëmbët të arrijnë gjunjët.
5. Vënia e ballit në tokë (sexhde). Pas rukusë, rënia në tokë duke vënë gjunjët, duart, ballin dhe hundën. Vetëm mbështetja e ballit dhe hundës është e pamjaftueshme. Balli duhet të ndjejë fortësinë e truallit. Në xhemaatet e dendura, ata që ndodhen në radhën e pasme mund të bëjnë sexhde mbi shpinën e atyre që ndodhen në radhë para tyre.
6. Ndenjja e fundit (ka'dei ahire). Është ndenjja në fund të namazit sa për të kënduar lutjen “Ettehijatu”.

Vaxhibet e namazit

1. Fillimi i namazit duke thënë “Allahu Ekber”.
2. Këndimi i sures “Fatiha” në dy rekatet e para të namazeve farze dhe në çdo rekat të namazeve vitër dhe nafi.
3. Këndimi i “Fatihasë” para sures (së shkurter).



4. Këndimi në dy rekatet e para të namazeve farze si dhe në të gjitha rekatet e namazeve vitër dhe nafile të një sureje ose tri ajete sa sureja më e shkurtër ose një ajet të gjatë.
5. Vënia në tokë, bashkë me ballin, edhe të hundës.
6. Kryerja e dy sexhdeve njëra pas tjetrës.
7. Respektimi i rregullit të namazit, domethënë, kryerja e çdo shtylle sipas rregullit.
8. Ndenjja pas rekatit të dytë të namazeve tre e katër re- gatesh.
9. Këndimi i lutjes “Ettehijjatu” në ndenjjen e parë e të fundit.
10. Në namazet farze tre e katër rekatesh dhe ne namazin e vitrit, ngritja në këmbë pas lutjes “Ettehijjatu”.
11. Në rekatet e para e të dyta të namazeve të agimit, mbrëmjes dhe jatsisë kur falen me xhemaat, veçanërisht ne të gjitha rekatet e namazeve të xhumave e bajrameve, këndi- mi me zë nga imami i “Fatiha”-së dhe i sures apo ajeteve.



12. Këndimi individualisht dhe me zë shumë të ulët sa për ta dëgjuar vetë në të gjitha rekatet e namazeve të mesditës dhe pasdites (iqindisë), në rekatet pas ndenjjes së parë të namazeve të mbrëmjes dhe jatsisë.
13. Në namazin e teravive dhe në namazin e vitrit të falur pas teravive, këndimi me zë nga imami i “Fatihë”-se, sures apo ajeteve.
14. Personi i lidhur pas imamit të mos i këndojë “Fatihë”-në, suren apo ajetin.
15. Këndimi i lutjes së Kunutit në namazin e vitrit.
16. Shprehja e tekbireve shtesë në namazet e bajramit.
17. Në fund të namazit, dhënia selam djathtas e majtas.
18. Kur duhet, të bëhet sexhdeja e gabimit të harresës (sehv).
19. Në namaz, bërja e sexhdes kur këndohet një ajet sexhdeje.



Sunnetet e namazit

1. Duke filluar namazin, duke filluar në vitër “Kunutin” dhe duke shprehur tekbiret e bajramit, ngritja e duarve në lartësinë e veshëve dhe, pastaj, lidhja e tyre.
2. Në rekatin e parë të çdo namazi, këndimi individualisht pa zë i “Subhaneke”-s dhe thënia e “Eudhu-Besmele”- së.
3. Në namazet individuale apo me xhemaat, thënia “amin” pas “Fatiha”-së.
4. Janë sunnet të gjitha tekbiret veç tekbirit të fillimit (iftitah) i cili është farz.
5. Duke u drejtuar nga rukuja, të thuhet
سَمِعَ اللهُ لِمَنْ حَمِدَهُ
«Semiallahu limen hamideh» dhe, pas saj,
رَبَّنَا لَكَ الْحَمْدُ «Rab- bena lekel hamd».
6. Në ruku, të thuhet tri herë سبحان ربي العظيم «Subhane Rabbijel adhim» dhe në të dyja sexhdet, nga tri here سبحان ربي الأعلى «Subhane Rabbijel a»la».
7. Në ruku, kapja e kupës së gjurit me pëllëmbët me gishtat të hapura, mbajtja e gjunjëve dhe bërrylave të pathyera, mbaj-



tja e shpinës dhe kokës horizontalisht, në një vijë.

8. Rënia në sexhde duke vendosur në tokë me radhë gjunjët, duart, fytyrën, kurse në ngritje, duke ngritur me radhë fytyrën, duart, gjunjët. Për personat pa të meta, mbajtja në sexhde e fytyrës mes duarve.
9. Në ndenjje, vendosja e pëllëmbëve mbi gjunjë; këndimi i lutjes «Ettehiyyatu» pa zë; në ndenjjen e fundit, pas lutjes «Ettehiyyatu», këndimi i lutjeve «Allahumme sal»li» dhe «Allahumme barik», etj.
10. Dhënia selam duke kthyer kokën një herë djathtas, pastaj majtas e duke thënë: السلام عليكم ورحمة الله “Esselamu alejkum ve rahmetullah».

Etika e namazit

Në namaz, gjatë qëndrimit në këmbë, shikimi në vendin ku do të vihet balli në sexhde, në ruku, shikimi mbi shpinën e këmbëve, në ndenjje, shikimi mbi duart e vendosura mbi gjunjë dhe, gjatë dhënies së selamit, shikimi mbi supe, janë veprime të pëlqyeshme që përbëjnë etikën e namazit.



Sexhdeja e gabimit të harresës (sehv)

Kjo sexhde duhet bërë kur vonohet kryerja e njërit prej farzeve të namazit ose lënia apo vonimi i vaxhibeve.

Për shembull, harrimi i lutjeve të Kunutit në namazin e vitrit; në rastet kur pas «Fatiha»-së duhet kënduar një sure e shkurtër, harrimi i saj dhe kalimi në ruku; harrimi i uljes për ndenjjen e parë dhe këndimin e «Ettehijjat»-it; moskryerja e sexhdes kur në namaz këndohet një ajet i sexhdes, etj. Në këto raste duhet bërë sexhde sepse është lënë pa kryer një vaxhib.

Kurse në rastet si: në namazet farz tre e katër rekatesh dhe në namazin e vitrit, pas rekatit të dytë, mosngritja në këmbë menjëherë pas këndimit të «Ettehijjat»-it, por pasi të këndohet edhe «Allahumme sal»li-barik»; këndimi i sures së shkurtër pa kënduar «Fatiha»-në, sjellja ndërmend e gabimit dhe këndimi i «Fatiha»-së, duhet bërë sexhde sepse është vonuar një vaxhib.



Në rastet kur duhet bërë sexhdeja e gabimit, po qe se jepet selam duke harruar të kryhet ajo, namazi përkatës nuk duhet rifalur.



